

NJOFTIM MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AGJENCINË KOMBËTARE TË SHOQËRISË SË INFORMACIONIT “MBI ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË DHE RREGULLSHMËRISË FINANCIARE”.¹²

Nga auditimi në zbatim të programit të auditimit nr. 1134/1, dt. 11.12.2015, “*Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë ekonomiko-financiare*”, periudhën 01.01.2014 deri 31.12.2015, në përfundim të auditimit janë konstatuar disa mangësi dhe shkelje të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, të cilat më hollësisht janë trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit dhe në Vendimin nr. 84, datë 30.06.2016 të Kryetarit të KLSH-së, të cilat janë përcjellë me shkresën nr. 1134/20, datë 04.07.2016, si edhe Vendimin nr. 129, dt. 30.09.2016 të Kryetarit të KLSH-së, përcjellë me shkresën nr. 1134/41, dt. 13.10.2016 rezultoi:

A. NDRYSHIME PËR PËRMIRËSIME LIGJORE

1. Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) është institucion publik me statusin e personit juridik publik, krijuar me Vendimin Nr.248 datë 24.07.2007, në varësi të Ministrisë për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit dhe me objekt të veprimtarisë: *Zbatimin e politikave e të strategjive, për zhvillimin e sektorit të shoqërisë së informacionit (më poshtë SHI) dhe në veçanti të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (më poshtë TIK); bashkërendimin e programeve në fushën e SHI-së dhe në veçanti të TIK-ut; nxitjen e investimeve në fushën e SHI-së; hartimin e praktikave për ushtrimin e kompetencave që i jepen ministrit nga legjislacioni në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare; promovimin e teknologjive të reja në fushën e SHI-së; dhënien e kontributit në edukimin dhe nxitjen e përdorimit të TIK-ut nga publiku.* Më pas ka patur amendime me Vendimin Nr. 837, datë 29.7.2009; Vendimin Nr. 28, datë 20.01.2010; Vendimin Nr.26, datë 11.01.2012; Vendimin Nr.34, datë 31.01.2013.

Me Vendimin Nr.703 datë 29.10.2014 “Për Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit” është shfuqizuar Vendimi Nr.248 datë 24.07.2007, me ndryshime, dhe është përcaktuar statusi i Agjencisë si institucion publik qendror, si dhe është riformuluar objekti i aktivitetit duke shtuar *ofrimin e shërbimeve të përqendruara on-line për qytetarët përmes teknologjisë së informacionit e komunikimit (TIK) për qeverisjen elektronike.* Konstatohet se kjo Agjenci është krijuar dhe vazhdon të funksionojë dhe rregullojë veprimtarinë e saj, bazuar në Vendimin Nr.703, datë

1 Raportin Përfundimtar të Auditimit “Mbi Auditimit të Ushtruar Në Agjencinë Kombëtare Të Shoqërisë Së Informacionit “Mbi Zbatimin E Ligjshmërisë Dhe Rregullshmërisë Financiare”.¹ është Miratuar Me Vendimin Nr. 84, Datë 30.06.2016

² Në zbatim të programit të auditimit nr. 1134/1, datë 11.12.2015, ndryshuar me shkresën nr.1134/5, datë 15.02.2016, u krye auditimi “Mbi klasifikimin origjinal të informacionit sekret shtetëror”, për të cilin në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, është përgatitur një raport i veçantë auditimi nga auditues i certifikuar, i mbikëqyrur nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm dhe nga Drejtori i Departamentit Juridik, Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve, të certifikuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar. Raporti Përfundimtar i këtij auditimi, i konsideruar “konfidencial” dhe i miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.74, datë 30.06.2016, i përcillet subjektit në përputhje me rregullat e mbajtjes së dokumentacionit “sekret shtetëror”.

29.10.2014, të Këshillit të Ministrave, ndërkohë që referuar Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, në nenin 10, parashikohet mënyra e krijimit dhe funksionimit të agjencive autonome, “Agjencitë autonome krijohen dhe mbyllen me ligj”.

Gjithashtu konstatohet se kjo njësi publike pavarësisht se ka emërtimin si Agjenci, statusi juridik i saj qëndron midis statusit të institucioneve të vartësisë dhe statusit të Agjencive Autonome, pavarësisht kërkesave të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, nenit 6; nenit 10; nenit 20.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) në rolin e nxitësit të zhvillimit të mëtejshëm të sektorit të qeverisjes elektronike duhet të marrë iniciativën për të përgatitur dhe propozuar në Këshillin e Ministrave një projektligj, që ndër të tjera të bëjë rregullimin ligjor të statusit të kësaj Agjencie në mbështetje të kërkesave të Ligjit nr.90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” neni 10, i cili parashikon mënyrën e krijimit dhe funksionimit të Agjencive autonome, pika 1 e tij “Agjencitë autonome krijohen dhe mbyllen me ligj”.

Menjëherë

2. Konstatohet se niveli i shpenzimeve të prokuruar për mirëmbajtjen e sistemeve në fushën e teknologjisë së informacionit, për vitet 2014-2015, kapin vlerën 263.5 milionë lekë dhe vlerësohet që do të jenë në trend rritës në vitet në vijim. Shpenzimet e mirëmbajtjes shërbejnë për të garantuar sisteme jo vetëm të sigurta por edhe eficente. Vlerësojmë domosdoshmërinë e këtyre shpenzimeve, por nga auditimi konstatohet se baza rregullative ka hapësira lidhur me përcaktimin e llojeve të shërbimit që duhet të kërkohet për sistemet në fushën e teknologjisë, por edhe nivelet e larta të kostove në këtë lloj shërbimi. Kjo mangësi i krijoi grupit të auditimit problematika lidhur me trajtimin e plotë të këtyre procedurave.

Nga ana tjetër, në VKM nr.710, datë 21.08.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, në pikën 2 theksohet se “*Institucionet, të cilat janë duke zhvilluar sisteme të reja në fushën e teknologjisë së informacionit, duhet të parashikojnë marrëveshjen mbi nivelin e shërbimit (SLA) për mirëmbajtjen e këtyre sistemeve. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 4 (katër) vjet” dhe “*Institucionet, të cilat kanë sisteme ekzistuese, duhet të parashikojnë këtë marrëveshje mbi (SLA) për mirëmbajtjen e sistemeve. Kohëzgjatja e kësaj marrëveshjeje duhet të jetë jo më e shkurtër se 2 (dy) vjet”.* Ky përcaktim le hapësira për interpretim dhe shoqërohet edhe me implikime buxhetore të mëdha.*

Për sa më sipër është rekomanduar:

Autoriteti Kontraktor, AKSHI, që ka si objektiv zhvillimin e sektorit të shoqërisë së informacionit dhe në rolin e përfituesit të zhvillimeve të mëtejshme të sektorit të qeverisjes elektronike, duhet të përgatisë dhe propozojë për miratim në Këshillin e Ministrave, një Manual Udhërrëfyes për llojet e mirëmbajtjeve të sistemeve, shoqëruar dhe me elementët e kostos që shoqërojnë këto mirëmbajtje të cilat asnjëherë nuk mund të jenë më të larta se nivelet vjetore të amortizimit por nga ana tjetër duhet të orientohen ndaj praktikave më të mira ndërkombëtare. Shërbimi i mirëmbajtjes i marrë në operatorë vendorë asnjëherë nuk mund të kalojë përqindjen e kostos së shërbimit që deklaron në politikat e tij prodhuesi i sistemit.

Brenda vitit 2016

Nga AKSHI të kërkohet realizimi i një ndryshimi në lidhje me përcaktimin e saktë të periudhës së marrëveshjes SLA. Përdorimi i shprehjes “jo më e shkurtër” në rastin e periudhës së mirëmbajtjes, në pikën 2 të Vendimit nr.710, datë 21.08.2013, “Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit”, lë hapësira për interpretim apo shkak për përcaktime kohore subjektive ndërmjet subjektet publike.

Nisur nga fakti që shumë Autoritete Kontraktore po prokurojnë shërbime mirëmbajtje sistemesh, kërkohet që ndërhyrja të bëhet e menjëhershme, për të siguruar përdorimin e të njëjtit standard në përcaktimin e afateve mbi të cilat prokurohen këto lloj shërbimesh.

Menjëherë.

PËR AGJENCINË E PROKURIMIT PUBLIK

3. Nga auditimi i procedurave të prokurimit në këtë institucion, KLSH konstaton se Vendimi Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” në pikën 2 përcakton: “Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe ç) çmimet ndërkombëtare, të botuara. Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës”. Ky lloj përcaktimi krijon hapësira për vlerësime jo të kujdesshme të fondit limit, duke lejuar përdorimin e vetëm një metode, e cila shpesh herë konstatohet të mos marrë për bazë çmime të publikuara dhe transparente por bazohet vetëm në oferta të paraqitura nga operatorët ekonomik të interesuar për fitimin e këtyre procedurave. Një mënyrë e tillë megjithëse është ligjërish e saktë ka sjellë rritje jo të justifikuar të fondeve limit mbi të cilat realizohen më pas procedurat e prokurimit. Vetë përdorimi i termit “dhe/ose” për alternativat e përdorura, krijon hapësira ligjërish korrekte, për kryerjen e procedurave formale në llogaritjen e fondit limit dhe për rrjedhojë cenimin e transparencës dhe efektivitetit të procesit të prokurimeve (nenet 1 pika 2 (dh) dhe 2 (b) të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar “Për Prokurimin Publik”).

Për sa më sipër është rekomanduar:

Me qëllim rritjen e efektivitetit në procesin e prokurimeve në përputhje me nenet 1 pika 2, dh dhe 2, b të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, ndryshuar “Për Prokurimin Publik”, por edhe për të eliminuar mundësitë që operatorët ekonomikë të orientojnë dhe përcaktojnë nivelin e fondit limit që do të prokurohet, APP të nisë procedurat për të amenduar Vendimin Nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, nenin 59 “Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës” duke sanksionuar:

– *Domosdoshmërinë e përgatitjes së fondit limit bazuar në vlerësime të informacionit të marrë nga shumë alternative, duke përfshirë edhe të dhënat e publikuara nga INSTAT. Të kërkohet eliminimi i përcaktimit të fondit limit bazuar vetëm në oferta të marra nga operatorë të ndryshëm në treg, si dhe të përcaktohet një renditje e alternativave sipas rëndësisë, duke bërë heqjen e*

termit “dhe/ose”, në mënyrë që të mos krijohen hapësira ligjore që përlllogaritja e fondit limit të bëhet subjektivisht.

– Në rast të marrjes së informacionit të kostos nga operatorë ekonomikë, të përcaktohet që “OE që jep ofertë për përlllogaritjen e fondit limit duhet t’i kërkohet edhe dokumentacion që të vërtetojë se plotëson kërkesat që AK do të vendosë në DST”.

Amendimet i shikojmë të rëndësishme për të eliminuar procedurat formale të llogaritjes së fondit limit, lënien e tyre në varësi të ofertave të marra nga operatorët e ndryshëm ekonomikë, të cilët diktojnë edhe çmimet e shërbimeve. Kjo problematikë është e përhapur në procedurat e prokurimit që kryejnë autoritetet kontraktore, por në rastin e Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, efektet financiare në llogaritjen e fondit limit janë më të konsiderueshme, për shkak të tregut të përqendruar të kësaj industrie.

Brenda vitit 2016

B. MASA ORGANIZATIVE:

1. Nga auditimi mbi programimin dhe zbatimin e buxhetit, konstatoam paqëndrueshmëri të programimit fillestar të buxhetit, kryesisht në zërin investime. Kështu, për periudhën objekt auditimi, programimi i PBA në të dy fazat e saj për fondet e investimeve, është hartuar dhe aprovuar me ndryshime të theksuara projektsh dhe vlerash, problematikë më e theksuar për vitin 2015. Programimi i PBA 2015-2017 për investimet e vitit 2015 është i përbërë nga 11 projekte, në vlerë 1,418,000 mijë lekë, ose 4 herë më shumë se shpenzimet e investimeve të realizuara një vit më parë.

Projekt buxheti i vitit 2015, është programuar për 11 projekte, në vlerë 1,783,200 mijë lekë, ose me një diferencë 365,200 mijë lekë nga PBA 2015-2017, pra 25.7% më shumë. Ndryshimet janë konstatuar në programet: “Realizimi i kushteve të AKSHI-t”, për 160,000 mijë lekë; “Disaster Recovery Centre DRC”, për 160,000 mijë lekë; “Marrëveshja e shërbimit për sistemet e ndërveprimit dhe shtim shërbimesh të reja elektronike në platformën qeveritare të ndërveprimit” për 35,200 mijë lekë; “Unified C (Lync Server) GovNet”, për 10,000 mijë lekë. Në dosjen shoqëruese të projekt buxhetit për vitin 2015, nuk kishte argumentim të dokumentuar për domosdoshmërinë e rritjes së vlerave për këto projekte.

Në Ligjin nr.160/2014 “Për miratimin e Buxhetit vjetor 2015”, shpenzimet për investime të aprovuara janë për 9 projekte, në vlerë 402,700 mijë lekë, me diferencë nga projekt buxheti, në vlerë 1,380,500 mijë lekë, ose 4.4 herë më pak se projekt buxheti i vitit 2015, duke lënë pa aprovuar rreth 50% të projekteve të programuara, shtuar 5 projekte të reja dhe aprovuar me diferenca 4 projekte.

Në dosjen shoqëruese të projekt buxhetit për vitin 2015, nuk kishte argumentim të dokumentuar për mos aprovimin e 7 projekteve të programuara, pakësimin e vlerës së 4 projekteve të programuara dhe domosdoshmërinë e shtimit të 5 projekteve të reja. Fakt i rëndësishëm është që financimi i pjesshëm i projekteve të caktuara, çon në shtrirjen në kohë të projekteve dhe mund të ndikojë në cilësinë e realizimit të tyre, duke ditur që ndryshimet e teknologjisë së informacionit janë të vullshme.

Konstatuam që në kundërshtim me kërkesat e nenin 65 “Monitorimi” të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ky institucion nuk ka hartuar raporte monitorimi për shpenzimet buxhetore e për rrjedhojë nuk ka bërë analizën e kostove për produktet e programuara dhe të realizuara në vitet 2014 dhe 2015 (trajtuar më hollësisht në faqen 15-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër është rekomanduar:

Strukturat drejtuese të këtij Institucioni, Sektori i Financës dhe Shërbimeve, në bashkëpunim me Grupet e Menaxhimit të programeve dhe me strukturat që mbulojnë planifikimin dhe monitorimin e investimeve në Ministrinë e Financave, të përcaktojnë qartë në programimin e PBA, por dhe në planifikimin vjetor, shpenzimet e domosdoshme të investimeve për arritjen e objektivave. Programimi i investimeve të jetë i specifikuar që në projekt-ide e deri në realizimin e tyre, në mënyrë që të mos rezultojë formal i gjithë programimi për investimet dhe të shmangen ndryshimet materiale, nga faza e programimit të PBA e deri tek plani përfundimtar vjetor i investimeve.

Të analizohen kostot e produkteve të programuara dhe të realizuara dhe të analizohet performanca financiare e tyre si pjesë e kërkesave të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”

Menjëherë

2. Nga auditimi u konstatua se Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit gjatë vitit 2015, për zhvillimin e projekteve në kuadër të strategjisë sektoriale, për një pjesë të këtyre projekteve, ka përfutur financim nga Fondi i Zhvillimit Rajonal. AKSHI ka aplikuar në FZHR për rreth 20 projekte, nga të cilat janë miratuar dhe financuar 12 prej tyre me një fond në total prej 728,497 mijë lekë dhe realizim në vlerën 88,586 mijë lekë. Gjatë vitit 2015, Ministria e Financës, ka alokuar nga FZHR, fondet sipas analizës së mëposhtme:

-Me shkresën nr.3979/1, datë 20.03.2015, konfirmohet alokimi i fondeve për 4 projekte investimi, në vlerën 259,976 mijë lekë;

-Ministria e Financës me shkresën nr.4423/1, datë 27.03.2015, konfirmon alokimin e fondit për 1 projekt, në vlerën 44,601 mijë lekë, “Lidhja e komisariteve dhe DPPSH me rrjetin e GovNet”, në vlerë të plotë 44,601 mijë lekë dhe e gjitha për vitin 2015;

-Me shkresën nr.8516/2, datë 10.06.2015 konfirmohet alokimi i fondit për 2 projekte investimi, në vlerën 246,667 mijë lekë, për “Shtimi i 209 shërbimeve të reja elektronike për 18 institucione në portalin qeveritar e-albania, sipas marrëveshjes me institucionet përfutuese, faza e I”, në vlerë të plotë 332,053 mijë lekë dhe për vitin 2015, në vlerë 166,027 mijë lekë dhe “Sistemi muntifunksional i qendëruar i lejeve të ndërtimit e-lejet”, në vlerë të plotë 115,200 mijë lekë dhe për vitin 2015, në vlerë 80,640 mijë lekë (kosto totale e projektit në projektin e dërguar është 175,440 mijë lekë, pra 60,240 mijë lekë nga njësitë e qeverisjes vendore);

-Ministria e Financës me shkresën nr.11148/2, datë 04.08.2015 konfirmon alokimin e fondit për 1 projekt, në vlerën 5,940 mijë lekë, “Promovimi dhe vendosja e sporteve dixhitale për portalin e-albania (faza pilot)”, në vlerë të plotë 7,920 mijë lekë dhe për vitin 2015, në vlerë 5,940 mijë lekë (në projektin e dërguar vlera e plotë e tij është 47,597 mijë lekë);

-Ministria e Financës me shkresën nr.11440/1, datë 07.08.2015 konfirmon alokimin e fondit për 1 projekt, “Implementimi i shërbimeve online të Ministrisë së Punëve të Jashtme”, në vlerë të plotë 56,337 mijë lekë dhe për vitin 2015, në vlerë 28,169 mijë lekë;

-Ministria e Financës me shkresën nr.14881/3, datë 01.12.2015 konfirmon alokimin e fondeve për 3 projekte (për vitin 2015), në vlerën 143,144 mijë lekë, konkretisht “Implementimi i sistemit për njoftim dhe konsultim publik”, në vlerë të plotë 11,289 mijë lekë dhe për vitin 2015, në vlerë 1,129 mijë lekë (në projektin e dërguar vlera e plotë është 16,694 mijë lekë), “Rritja e sigurisë fizike e dixhitale në shkollat të arsimit të mesëm, ndërtimi i platformës multidimensionale të komunikimit”, në vlerë të plotë 339,254 mijë lekë dhe për vitin 2015, në vlerë 67,851 mijë lekë

(në projektin e dërguar vlera e plotë është 508,880 mijë lekë), “Përditësimi dhe përmirësimi i të dhënave në ZRPP Tiranë”, në vlerë të plotë 370,827 mijë lekë dhe për vitin 2015, në vlerë 74,165 mijë lekë.

Konstatuam se përveç formatit të aplikimit si dhe shkresës përcjellëse, nuk ka asnjë analizë të mirëfilltë teknike apo analizë kosto-përfitim, analizë ekonomike për këto projekte. Në disa raste bashkëngjitur formateve të aplikimit ndodhen oferta të marra nga kompani që operojnë në treg, të cilat japin çmime bazuar në preventiva të hartuar, por që nuk ekziston (apo na u paraqit) asnjë dokument se si dhe mbi ç’bazë u hartuan këto preventiva dhe si arritën te operatorët e tregut. Lehtësisht konstatohet se vlera e këtyre projekteve është vendosur nga vetë operatorët e tregut, të cilët më pas në procedurat e tenderimit, janë konkurrentë për kontratat e zbatimit, ndërkohë që nga institucioni nuk ka ose nuk dokumentohet kryerja e analizës së zërave të koston së këtyre projekteve nga përgjegjësit në AKSHI, të cilët kanë firmosur formatin e aplikimit.

Në dosjen me dokumentet të paraqitura grupit të auditimit, shumica e formatit të aplikimit nuk janë të nënshkruara nga miratuesit e projektit: Drejtuuesi i Projektit, Përgjegjësi për proceset TIK, nga sektorët që e përgatisin projektin: Përgjegjësi TIK, Drejtoria e Modernizimit të Shërbimeve dhe zhvillimeve e-Gov, nga rishikuesit e projektit, Përgjegjësi i Sigurisë së TIK-ut, si dhe personi i kontaktit (trajtuar më hollësisht në faqen 150-155 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër është rekomanduar:

Nga ana e AKSHI-t, për çdo projekt të propozuar, të ketë studime të thelluara dhe konkurrim të hapur për projekte dhe ide novatore, duke mos mbetur vetëm në kuadrin e punës së punonjësve dhe specialistëve të Institucionit, të cilët në shumicën e rasteve nuk kanë kualifikimet apo dhe kompetencën për të hartuar projekte të natyrave të tilla. Çdo projekt i propozuar të ketë analiza të mirëfillta teknike dhe financiare në mënyrë që vendimmarrja të bazohet në analizën kosto-përfitim.

Nga ana e AKSHI-t të ketë analizë reale tregu për çdo element të projekteve dhe kosto e tyre të merret nga kompani që operojnë në tregjet ndërkombëtare, çmimet e të cilave bazohen në preventiva transparent, duke eliminuar praktikën e përcaktimit të vlerës së këtyre projekteve nga vetë operatorët e tregut, të cilët më pas në procedurat e tenderimit, janë konkurrentët për fitimin e kontratave të zbatimit.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Nga auditimi u konstatua se në vitin 2014, janë prokuruar 14 objekte prokurimi “Investime” me fond limit 437,565 mijë lekë dhe vlerë të prokuruar 405,751 mijë lekë dhe 45 objekte prokurimi “Shpenzime” me fond limit 75,417 mijë lekë dhe me vlerë të prokuruar 64,077 mijë lekë. Janë kryer 42 procedura prokurimi me blerje të vogla, 5 procedura “Negocim pa shpallje paraprake të kontratës”, 7 procedura “Kërkesë për propozim” dhe 5 procedura “E hapur” (me fond limit 447,624 mijë lekë, ose 87.3% të të gjithë prokurimeve).

Për vitin 2015, janë prokuruar 14 objekte prokurimi (2 me procedurën “Kërkesë për propozim” dhe 12 “E hapur”) me fond limit 1,771,104 mijë lekë pa tvsh dhe me vlerë të prokuruar 1,835,714 mijë lekë me tvsh dhe 45 objekte prokurimi “Shpenzime” me vlerë të prokuruar 10,203 mijë lekë me tvsh me procedura prokurimi me blerje të vogla.

Nga auditimi i procedurave të prokurimit në grupin “Investime”, kemi konstatuar që përlllogaritja e fondit limit, rezulton të jetë kryer vetëm mbi bazë të çmimeve të ofruara nga operatorët, të cilët janë dhe ofruesit e vetëm në tregun e brendshëm të këtyre shërbimeve/mallrave.

1. Nga auditimi i prokurimeve me objekt shërbimet e mirëmbajtjes të sistemeve të implementuara, konstatuam se për 11 objektet me vlerë 713,573 mijë lekë, prokurimi i të cilave është realizuara në vitet 2014 - 2015, nga Autoriteti Kontraktor janë parashikuar fonde për mirëmbajtje vjetore në vlerën 263,452 mijë lekë, vlerë që përbën rreth 37 % të vlerës kontabël të sistemeve të implementuar. Konstatohet se përlllogaritja e fondit limit në këto procedura prokurimi është bërë vetëm me testim tregu (bazuar në ofertat e operatorëve vendas që operojnë në këtë treg), pa u thelluar në analiza të veçanta për çdo zë të preventivit, duke sjellë përcaktim të fondit limit me kosto shërbimi që tejkalon nivelin e amortizimit vjetor të sistemit, ndërkohë që duke zbatuar standardet kontabël, shpenzimet e mirëmbajtjes në asnjë rast nuk mund të kalojnë nivelet e amortizimit vjetor. Për çdo tejkallim të mundshëm, shpenzimi duhet të kalojë në vlerën e investimit dhe nuk mund të trajtohet si shpenzim mirëmbajtje vjetore. Nga ana tjetër, megjithëse institucioni është autoriteti kryesor, kompetent në implementimin e risive në fushën e teknologjisë së informacionit apo në promovimin e sistemeve informatike, nuk konstatuam asnjë përpjekje për të analizuar eksperiencat e ngjashme në botë, duke u mjaftuar me përlllogaritjen e fondit limit sipas ofertave të OE, që cilat janë të interesuarit kryesorë për realizimin e objekteve të prokurimit.

Duke audituar disa objekte prokurimi të realizuara në këtë institucion për të cilat janë parashikuar mirëmbajtje vjetore për shërbime, Software dhe Hardware, konstatuam nivele të larta të kostove të mirëmbajtjes të cilat tejkalojnë edhe nivelin e shpenzimeve të mirëmbajtjes të lejuara për tu njohur sipas përcaktimeve të Ligjit nr.9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Niveli e kostove të mirëmbajtjes është më i lartë edhe se niveli i amortizimit vjetor të llogaritur për këto lloj sistemesh, fakt që tregon pakujdesi në llogaritjen e fondit limit.

2. Përlllogaritje e pakujdesshme e fondit limit, ndeshet edhe në procedura të blerjeve apo zhvillimit të platformave. Kështu në procedurën e prokurimit me objekt “*Blerje software për përpunimin e të dhënave, Arshiva e digjitalizuar dhe pajisje skanimi, server + pajisje depoz të dhëna Arsh dig*”, me fond limit me tvsh 60,763 mijë lekë grupi i auditimit u konstatua se gjatë përlllogaritjes, mesatarja aritmetike e vlerave të ofertuara është përpikmërisht e njëjtë me të gjitha vlerat e ofertuara nga OE [] shpk. Kjo tregon që përlllogaritja e fondit limit është fiktive, e bërë në të njëjtën zyrë dhe e paanalizuar nga grupi i punës. Fakti që edhe në regjistrin e parashikimit të prokurimeve të vitit 2015, përcjellë në APP me shkresën nr.72, datë 16.01.2015, fondi limit i përgjithshëm është 29,1667 mijë lekë pa tvsh, tregon se me këtë përlllogaritje është rritur fiktivisht fondi limit.

3. Në procedurën e prokurimit “E hapur”, me objekt “Shtimi i 209 shërbimeve elektronike për 18 institucione”, me afat të zbatimit të kontratës 18 muaj për implementimin dhe 4 vjet mirëmbajtje, nga data e nënshkrimit të kontratës”, megjithëse grupit të punës të ngritur për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit i është kërkuar që “*Përlllogaritja e fondit limit të bëhet duke iu referuar testim të tregut, eksperiencave të ngjashme dhe/ose publikimeve zyrtare, konform legjislacionit në fuqi*”, përlllogaritja e fondit limit bazuar në testimin e tregut është bazuar vetëm në ofertat e katër operatorëve ekonomikë. Pas marrjes së këtyre ofertave ([] dhe []), nga ana e grupit të punës është bërë mesatarja aritmetike e ofertave të paraqitura dhe

është përlllogaritur fondi limit në vlerën 316,178 mijë lekë pa tvsh, nga të cilat 263,556 mijë lekë për implementim e shërbimeve dhe 52,622 mijë lekë mirëmbajtje për 4 vjet. Në dosje nuk administrohet asnjë dokument ku të bëhet analiza e zërave të ofertuar, bazuar edhe në eksperiencat e mëparshme të vet institucionit, pasi rezultoi se në prill të po këtij viti është lidhur një kontratë e ngjashme me një nga ofertuesit e mësipërm (■ dhe oferta e dhënë nga ky ofertues për shtimin e një shërbimi është mesatarisht 934,831 lekë pa tvsh (83,200,000 lekë : 89 shërbime). Anashkalimi i metodës bazuar në kontrata të ngjashme në përlllogaritjen e fondit limit për objektin “Shtimi i shërbimeve të reja elektronike në Portalin Qeveritar e-Albania”, sipas të cilës fondi limit i llogaritur do të ishte 248,002 mijë lekë pa tvsh, ka sjellë një kosto shtesë prej 68,176 mijë lekë në llogaritjen e fondit limit të prokuruar.

4. Në procedurën e prokurimit me objekt “Mirëmbajtja e sistemeve Oracle Audit Vault (përfshirë mirëmbajtjen për periudhën 2 vjeçare)”, me afat të zbatimit të kontratës 24 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës, u konstatua se grupi i punës e ka bërë përlllogaritjen e fondit limit bazuar vetëm në ofertat e tre operatorëve ekonomikë (■ dhe ■) në vlerën 10,800 mijë lekë pa tvsh. Nga auditimi rezulton se në termat e referencës kërkohet të mirëmbahet “Oracle Audit Vault për bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, “Oracle Audit Vault për bazën e të dhënave për sistemin CMIS të administruar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore” dhe “Oracle Audit Vault për bazën e të dhënave të Agjencisë së Prokurimit Publik”. Nga realizimi i prokurimeve të vitit 2014, konstatohet se nëse do të merrej për bazë përqindja e mirëmbajtjes në lidhje me implementimin, përdorur nga vetë AK, me 22%, fondi limit i kësaj procedure prokurimi do të ishte 7,438 mijë lekë pa tvsh ose 3,362 mijë lekë më pak se fondi limit i prokuruar (trajtuar më hollësisht në faqen 76-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër është rekomanduar:

Autoriteti Kontraktor të marrë masa që, nëpërmjet strukturave teknike në dispozicion, në të gjitha rastet e prokurimeve mallra apo shërbime, por kryesisht për shërbime mirëmbajtje, në përlllogaritjen e fondit limit të mbahet parasysh një nivel standard në koston e këtij shërbimi që në çdo rast nuk mund të tejkalojë koston e amortizimit vjetor të aktivitetit të cilit i shërben, bazuar mbi eksperiencat më të mira ndërkombëtare, me qëllim moscenimin e parimit të ekonomicitetit në prokurime.

Menjëherë dhe në vijimësi

4. Në disa nga procedurat e prokurimit të audituara, si: “Lidhja e sistemeve në platformën qeveritare të ndërveprimit dhe shtimi i shërbimeve të reja në portalin qeveritar e-Albania”, “Lidhja me fibër optike e Komisarivateve të Policisë dhe drejtorive nëpërmjet rrjetit qeveritar Govnet” dhe “Blerje software për përpunimin e të dhënave, Arshiva e digjitalizuar dhe pajisje skanimi, server + pajisje depoz të dhëna Arsh dig”, është konstatuar se disa nga kriteret e veçanta të kualifikimit janë diskriminuese, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 dhe që nuk përputhen me natyrën dhe volumet e objektit që prokurohet. Ky veprim ka orientuar tenderët drejt operatorëve të caktuar.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Strukturat e caktuara për vendosjen e kriterëve të kualifikimit, të marrin masa që të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën

diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre dhe të përputhen në natyrë dhe sasi me preventivat e objekteve që prokurohen, duke krijuar mundësitë për një konkurrencë të hapur që do të shoqërohet edhe me rritje të ekonomicitetit të fondeve të prokuruar.

Në vijimësi

5. Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE” rezulton se është bërë dorëzimi i mallrave të prokuruar me akteve të marrjes në dorëzim nr. 1264/1, datë 05.09.2014 dhe nr. 1264/2, datë 05.09.2014, për 8 licencat Oracle DB, 8 licenca Oracle diagnostic, 8 licenca Oracle Tunning Pack, 1/8 Oracle DB Machine, Tape Library, Tape, Kasafortë.

Pagesa për suportin e vitit të dytë, është bërë me urdhër shpenzimin nr. 233, datë 04.11.2015 në vlerën 15,876,000 lekë, pas aktmarrjes në dorëzim nr. 1869/1, datë 29.09.2015, ndërkohë që viti i dytë i mirëmbajtjes fillon në 05.09.2015. Pra, është bërë pagesa për mirëmbajtjen vjetore të pajisjeve pa u kryer shërbimi.

Konstatohet se në dokumentet e tenderit të hedhura në sistem, në nenin 6 të kushteve të veçanta të kontratës citohet: *Pagesa e Mallrave duhet bërë brenda__ (bosh) ditëve nga data e pranimit të Mallrave ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim te pagesës, sado vonë që të vijë. Nëse nuk është specifikuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.* Ndërsa në Kontratën e lidhur, neni 6 i kushteve të veçanta kërkohet “*Në lidhje me pagesën e shërbimeve SLA(suporti), AK duke iu referuar politikave të Oracle, e cila kërkon në avancë për 1 vit pagesën e suportit SLA, bie dakord që pagesa e shërbimeve SLA të jetë vjetore dhe të paguhet në fillim të çdo viti, brenda 30 ditësh nga data e lëshimit të faturës tatimore*”. Ndryshimi i dokumenteve të tenderit në fazën e lidhjes së kontratës është në kundërshtim me nenin 60, pika 1 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006” Për prokurimin Publik” i ndryshuar. Pagesat e mësipërme, i janë referuar nenit 6 të kushteve të veçanta të kontratës “Kushtet e pagesës”, nen i pambështetur ligjërisht, pasi prodhuesi Oracle i cituar në të, nuk figuron të jetë pjesë e kontratës (*trajtuar më hollësisht në faqen 79-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër është rekomanduar:

Autoriteti Kontraktor, të marrë të gjitha masat për shmangien e pagesave vjetore paradhënie, sidomos kur bëhet fjalë për shërbim të pakryer, duke bërë saktësimet e nevojshme në kontratat e lidhura, për të kryer pagesa për shërbimin mbi bazë mujore dhe bazuar në raportet e kryerjes së shërbimit.

Nëse nivelet e kostove ndjekin politikat e çmimeve të prodhuesit të sistemeve, atëherë duhet të kalohet në marrjen e shërbimeve ekskluzivisht tek prodhuesi i huaj i sistemit (tarifat e shërbimit të të cilit janë transparente dhe publike për të gjithë kërkuarit e tyre), duke nënkuptuar lidhjen e kontratave të drejtpërdrejta me prodhuesin.

Në vijimësi

6. Nga auditimi i problemeve të Sigurisë në Rrjetin Qeveritar Govnet dhe Qendrën e të Dhënave Qeveritare kemi konstatuar:

a. Agjencia Kombëtare e Sigurisë Kompjuterike (ALCIRT)³ me shkresën nr. 984, datë 02.12.2013 i dërgon Drejtoreshës së Përgjithshme të AKSHI-t znj. [REDAKTUAR], një raport⁴ mbi testimin nga jashtë të kryer nga kjo Agjenci, me qëllim identifikimin e dobësive problemeve apo konfigurimeve jo të duhura të shërbimeve të hostuara në ambientet e AKSHIT, të cilat mund të përdoren nga Hacker-at për të sulmuar apo thyer ato. ALCIRT i rekomandon AKSHIT marrjen e masave për rregullimin e problemeve të shfaqura, duke i ofruar edhe mundësinë e bashkëpunimit.

Brenda një periudhe të shkurtër kohore, janë verifikuar raste të thyerjeve të faqeve web të institucioneve të hostuara në ambientet e AKSHIT. Kështu në datën 28.07.2014 rezultojnë të thyera 17 faqe institucionesh nga hackers “RedAnons_AL”.

Në datën 11.9.2014 rezulton e thyer faqja web Kryeministria.al nga hackers “RedAnons_AL”.

Në datën 18.8.2015 rezultojnë të thyera nga hackers “Nofawkx AL” 6 faqe institucionesh. Për këtë rast znj. [REDAKTUAR] Drejtor i Përgjithshëm i AKSHIT më 20.08.2015 i është drejtuar z. [REDAKTUAR] Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit me objekt “Denoncim i sulmeve kibernetike”

Në datën 18.1.2016 rezultojnë të thyera nga hackers “Nofawkx AL” 9 faqe institucionesh.

Në datën 1.4.2016 rezulton e thyer faqja web tirana.gov.al nga hackers “RedAnons_AL”.

Gjykojmë se mungesa e bashkëpunimit midis AKSHI-t dhe ALCIRT si dhe me stafin e IT të Institucioneve përkatëse në lidhje me raportin e datës 02.12.2013, mbi testimin nga jashtë të kryer nga kjo Agjenci, me qëllim identifikimin e dobësive problemeve apo konfigurime jo të duhura të shërbimeve të hostuara në ambientet e AKSHIT, mundësuan që Hacker-at të sulmojnë apo thyejnë ato.

Gjithashtu konstatojmë se nuk ka një analizë profesionale të shkaqeve që kanë çuar në thyerjen e faqeve, nuk janë marrë në konsideratë rekomandimet e raportit të Agjencisë Kombëtare e Sigurisë Kompjuterike (ALCIRT), si dhe anashkalohet e nuk përmendet roli i templateve “free” në komprometimin e sigurisë së faqeve zyrtare të internetit. AKSHI nuk ka reaguar dhe reflektuar mbi incidentet e ndodhura për reflektimin e tyre në rregulloren e ndërtimit të faqeve web të administratës publike (versioni aktual 02/12/2008 i njëjtë me atë të krijimit).

b. Për rritjen e sigurisë Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit fillon procedurat e prokurimit me objekt “Rritja e Sigurisë në Rrjetin Qeveritar Govnet dhe Qendrën e të Dhënave Qeveritare”, sipas Urdhrit të Brendshëm të datës 10.02.2014, ku përcaktohet ngritja e komisionit për përcaktimin e specifikimeve teknike si dhe llogaritja e fondit limit të kontratës për procedurën e prokurimit. Grupi i punës së hartimit të specifikimeve më datë 16.05.2014 nr. Prot 675 i drejtohet znj. [REDAKTUAR] për aprovim specifikimesh. Operatori Ekonomik In i drejton AK, ankesën me nr.842, datë 10.06.2014 për kriteret e vendosura për këtë procedurë prokurimi, të cilës i është kthyer përgjigje në datën 12.06.2014. Duke marrë parasysh disa nga kërkesat e OE [REDAKTUAR] Shpk, AK kryen modifikimin e dokumenteve të tenderit me Urdhrin nr. 858 datë 12.06.2014. Por Komisioni i Prokurimit Publik i vënë në lëvizje pas ankesës së OE [REDAKTUAR] Shpk me shkresën nr. 921 datë 23.06.2014 i dërgon urdhrin nr. 1105/1 datë 23.06.2014 për pezullimin e procedurës dhe kalimin e shqyrtimit në themel të procedurës së prokurimit me objekt “Rritja e Sigurisë në Rrjetin Qeveritar Govnet dhe Qendrën e të Dhënave Qeveritare”.

KPP me shkresën nr. 385/1 datë 11.07.2014 (protokolluar në datë 14.07.2014 nr. 1021 në AKSHI) dërgon vendimin për mos pranim të ankesës së OE [REDAKTUAR] Shpk dhe urdhëron vazhdimin e procedurës. Autoriteti Kontraktor në pamundësi të vazhdimin të procedurave të prokurimit për

³ Në zbatim të ligjit “Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Sigurisë Kompjuterike” nr. 766 datë 14.08.2011 pika 2

⁴ Raport bashkëlidhur shkresës i detajuar për faqet web e cdo institucioni që hostohet në ambientin e AKSHIT

shkak të mos shtyrjes së afatit të ofertave pas heqjes së pezullimit të procedurës, nxjerr urdhrin për anulimin e procedurës.

AK rifillon procedurat e prokurimit me Urdhrin e prokurimit nr. 1029 datë 14.07.2014 mbi “Rritja e Sigurisë në Rrjetin Qeveritar Govnet dhe Qendrën e të Dhënave Qeveritare” me fond limit të kontratës 80,821 mijë pa tvsh.

Konstatuam se nevoja për shërbime shtesë nuk është shkaktuar nga rrethana të paparashikuara, të pa njohura nga Autoriteti Kontraktor dhe këto shërbime duhet të mbuloheshin nën Kontratën nr. 1312, datë 12.09.2014. Përdorimi i procedurës së prokurimit “Negocim pa botim paraprak të njoftimit të kontratës” për rritjen e sigurisë në rrjetin qeveritar govnet dhe qendrën e të dhënave qeveritare me vlerë limit të kontratës 14,700 mijë lekë pa tvsh, është bërë në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në Ligjin Nr.9643, datë 20.11.2006, Neni 33 “Procedura me negocim, pa shpallje paraprake të njoftimit” Pika c.

Ndërkohë që thyerjet e faqeve web pas implementimit (më datë 18.8.2015, nga Hackers “Nofawkx AL”, më datë 18.1.2016 nga Hackers “Nofawkx” AL dhe më datë 1.4.2016 nga Hackers “RedAnoms AL”) tregojnë për mos efektivitet të investimeve, mos marrjen në konsideratë të përdorimit të mjeteve ekzistuese të sigurisë apo arritjen e saj nëpërmjet përdorimit dhe zhvillimit të burimeve njerëzore, (trajtuar më hollësisht në faqen 138-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër është rekomanduar:

Agjencia Kombëtare e Shërbimit të Informacionit, nëpërmjet strukturave të saj, të rrisë shkallën e bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse dhe të specializuara të sigurisë dhe luftës ndaj krimit kibernetik, me Agjencinë Kombëtare për Sigurinë Kompjuterike (ALCIRT) e cila në përputhje me legjisllacionin në fuqi ka në objekt të veprimtarisë identifikimin, parashikimin dhe marrjen e masave për mbrojtjen ndaj kërcënimeve/sulmeve kompjuterike.

Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të kryejë kontrollin për identifikimin e dobësive para çdo hostimi të ri të faqeve web apo aplikacioneve në ambientet e AKSHI-t, të rishikojë rregulloren e ndërtimit të faqeve web të institucioneve të administratës publike

Të marrë masa të rishikojë vazhdimisht normat e sigurisë për shërbimet që ajo kryen. Të kryejë, në çdo rast thyerjeje, analizë të shkaqeve të brendshme dhe të jashtme që çuan në incident dhe të denoncojë përgjegjësit. Të marrë masa për rritjen profesionale të kapaciteteve njerëzore në përputhje me kërkesat e sigurisë.

Menjëherë dhe në vazhdimësi

7. Nga auditimi i organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit për vitet 2014-2015, rezultuan mangësi e shkelje të rënda në dokumentimin dhe kontabilizimin e transaksioneve financiare.

a. Konstatuam mangësi në evidentimin e aktiveve të trupëzuara dhe qarkulluese për periudhën e audituar, në kundërshtim me rregullat bazë të njohjes dhe evidentimit të tyre në kontabilitet. Institucioni nuk ka libra analitikë të aseteve të patrupëzuara, të trupëzuara dhe libra analitikë për aktivet qarkulluese. Magazina e këtij institucionit ka funksionuar formalisht, me shkelje dhe mangësi, në kundërshtim me rregullat kontabël. Hyrjet e vlerave materiale, aseteve të trupëzuara dhe të patrupëzuara janë kontabilizuar gabim (gabime të cilat ishin në vlera të konsiderueshme), duke reflektuar në koston e tyre edhe shërbimet e mirëmbajtjes të lidhura me këto sisteme (IT). Dalja e vlerave materiale dhe aseteve nga magazina bëhej formalisht, pa “urdhër dorëzimi” dhe në shumicën e tyre firmoste vetëm magazinierja, duke krijuar risk të lartë në administrimin e

vlerave materiale të institucionit. Risku operacional ishte i lartë, edhe për faktin se magazinierja kryente dhe 3 detyra të tjera funksionale. Inventarizimi i vitit 2014 është kryer formalisht, pra pa rezultate të besueshme në përfundim të tij, ndërsa inventarizimi i vitit 2015, nuk është përfunduar akoma dhe bilanci i këtij viti është hartuar pa rezultatet e këtij inventarizimi, duke mos reflektuar rakordimin midis inventarit fizik dhe atij kontabël.

b. Në këtë institucion për asetet (llogaritë 214,213,215, 218) dhe për aktivet qarkulluese të institucionit, nuk përdoren fletë dalje (të brendshme), të cilat përbëjnë bazën e kartelave personale të punonjësve për asetet dhe aktivet qarkulluese në përdorim.

c. Për projektet e investimit të pa përfunduara, nuk është bërë evidentimi i tyre në llogaritë 230 dhe 231 “shpenzime për investime në proces”, por ato janë kontabilizuar direkt në llogaritë e aseteve të qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.

d. Konstatuam se veprimet për mbylljen e llogarive dhe për përpilimin e pasqyrave financiare për të dy vitet, janë kryer nga jashtë ditarëve dhe kontabilitetit. Pasqyrat financiare vjetore nuk kanë bashkëlidhur llogaritë analitike të aseteve, (pra aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe aktivet e qëndrueshme të trupëzuara), por edhe listat e këtyre llogarive analitike, sipas fletë hyrjeve, ishin me gabime në regjistrimin e llogarive dhe nuk ishin të ndara sipas projekteve të investimit. Mungonin edhe llogaritë analitike të aktiveve qarkulluese (*trajtuar më hollësisht në faqen 64-76 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër është rekomanduar:

Titullari i Institucionit dhe Sektori i Financës dhe Shërbimeve, të organizojnë pas regjistrimit dhe daljes së llogarive inventarizimin dhe kartelizimin e të gjitha aseteve dhe pajisjeve, në përputhje të plotë me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financës nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, në Kapitullin IV “Sistemi i kontrollit periodik të Aktiveve”, duke shmangur të gjitha shkeljet dhe mangësitë e sipërcituara.

Sektori i Financës dhe Shërbimeve të regjistrojë dhe kontabilizojë në mënyrë të rregullt dhe analitike të gjitha hyrjet dhe daljet e magazinës për të dy vitet 2014 dhe 2015, duke rregulluar të gjitha parregullsitë dhe shkeljet e cituara më lart, sidomos në regjistrimin dhe kontabilizimin e daljeve të magazinës, duke i plotësuar ato me nënshkrimet përkatëse dhe me dokumentacionin shoqëruar për secilën dalje (të brendshme apo të jashtme, urdhër dorëzimi e deri tek kartelat personale). Përfundimi i regjistrimit dhe kontabilizimit do të bëjë të mundur nxjerrjen e saktë të gjendjes së llogarive të aseteve dhe materialeve (214,213,215,218 dhe 312,327).

Brenda vitit 2016

8. Nga auditimi konstatohet se raporti numerik midis specialistëve dhe përgjegjësve të sektorit referuar kërkesave të Ligjit nr.90/12 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, si dhe VKM përkatëse, në vitin 2015 kjo strukturë ka rritur ndjeshëm numrin e përgjegjësve të sektorit nga 11 në 20 dhe drejtorëve të drejtorive nga 4 në 8 ndryshime sigurisht shoqëruar me kosto financiare për shkak të pozicioneve. Rezulton një strukturë organizative, e cila është e mbingarkuar me pozicione të tepërta në nivel drejtorish dhe sektorësh, duke mos zbatuar parimet bazë mbi të cilat organizohet dhe funksionon administrata shtetërore. Arrijmë në këtë konkluzion pasi nga auditimi konstatohet se shumë funksione dhe detyra, të cilat janë në përshkrimet e punës, mbulohen nga shërbime të kontraktuara me palët e treta dhe me kosto financiare respektive në vlera të konsiderueshme për Buxhetin e Shtetit. Gjithashtu për shkak të natyrës së ngjashme të punëve dhe funksioneve të ndërlidhura, mund të kishte grupim të disa

drejtorive në një dhe më pak sektor përkatës (*trajtuar më hollësisht në faqen 42-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër është rekomanduar:

Në funksion të mirë organizimit dhe funksionimit të strukturave të brendshme, nga AKSHI në bashkëpunim dhe DAP, të rishikohet struktura dhe organika e Institucionit, bazuar në përshkrime të sakta të punës për çdo pozicion pune, rigrupim të disa drejtorive në një dhe zvogëlimin e disa sektorëve për shkak të natyrës së ngjashme të punëve dhe funksioneve të ndërlidhura midis tyre. Të eliminohen nga funksionet e brendshme, shërbimet që kontraktohen nga jashtë institucionit.

Menjëherë

9. Nga auditimi në Sektorin e Burimeve Njerëzore, lidhur me plotësimin dhe ruajtjen e dosjeve të punonjësve, u auditua dokumentacioni i 15 punonjësve të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (në nivel Drejtori i Përgjithshëm, drejtor drejtorie, përgjegjës Sektori dhe specialist). Përgjithësisht rezulton se dokumentacioni është plotësuar sipas rregullave e në mbështetje të bazës ligjore përkatëse, por u konstatua se në kundërshtim me VKM nr.117 datë 5.03.2014 “ *Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit*”, me Kreu I “Dosja e Personelit”, Lidhja 1 dhe Lidhja 2, dosjet teknike të punonjësve *nuk ishin konform parashikimeve të shprehura në to, pasi mungonin: Fletë-inventarët me listën e dokumentacionit që ndodhet në dosje, e cila duhet të jetë e firmosur nga nëpunësi dhe specialisti i personelit; fleta prezantuese me të dhënat që duhet të përmbajë që nga numri i identifikimit, përshkrimet e karrierës, masat disiplinore, gjyqësore, pozicioni, paga bazë, shpërblime, etj. Në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse për vitin 2014 dhe 2015, janë depozituar vlerësimet e arritjeve vjetore individuale të punonjësve por që mbaheshin në një dosje të veçantë, pa u bërë pjesë e dosjes personale të punonjësve* (*trajtuar më hollësisht në faqen 42-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër është rekomanduar:

Sektori i Burimeve Njerëzore, të bëjë plotësimin dhe ruajtjen e dosjeve të punonjësve, me Fletë-Inventarë, me listën e dokumentacionit që ndodhet në dosje, e cila duhet të jetë e firmosur nga nëpunësi dhe specialisti i personelit, fleta prezantuese me të dhënat që duhet të përmbajë që nga numri i identifikimit, përshkrimet e karrierës, masat disiplinore, gjyqësore, pozicioni, paga bazë, shpërblime, etj, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore individuale të punonjësve të bëhen pjesë e dosjes personale të punonjësve.

Menjëherë

10. Nga auditimi konstatohet se në rregullore, përcaktohet qartë funksionimi i strukturës, përshkrimi i punës për çdo pozicion me detyra konkrete nga funksioni si Drejtori i Agjencisë, Drejtori i Drejtorisë, Përgjegjësi i Sektorit dhe Specialisti, por nuk janë përcaktuar kritere për rekrutimin e personelit, për të përshtatur pozicionin e punës me kualifikimin arsimor, gjë e cila ndikon në cilësinë dhe mbarëvajtjen e punës. Nga auditimi konstatohet se ka pozicione pune të cilët drejtohen nga punonjës të cilët nuk kanë kualifikimin e duhur arsimor sipas specifikës që kërkon pozicioni i punës si në rastin e Drejtorit të Drejtorisë së të Dhënave Shtetërore, (kualifikimi arsimor inxhinier naftë), Drejtorit të Drejtorisë së Portalit Qeveritar (kualifikimi arsimor jurist), apo përgjegjës sektori, të cilët kanë një vjetërsi në punë nga 10 muaj deri në dy vjet.

Nga auditimi i disa praktikave mbi rekrutimin e punonjësve konstatohet se përgjithësisht bëhej njoftimi në faqen zyrtare të AKSHI-t, por Komitetet ad-hoc të ngritura me urdhër të titullarit, përgjithësisht janë ngritur në nivel specialistësh dhe një drejtor. Ndërkohë që faza e testimit dhe niveli i tij janë shumë i ulët krahasuar me pozicionin e punës dhe kriteret që duhet të përmbushin kandidatët që konkurrojnë (*trajtuar më hollësisht në faqen 42-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër është rekomanduar:

AKSHI të rishikojë përbërjen e Komiteteve ad-hoc të ngritura me urdhër të titullarit, duke ngritur nivelin profesional me specialistë të mirëfilltë të fushës, në funksion të përzgjedhjes së kandidatëve me nivel të lartë, siç i takojnë këtij Institucioni specifik për nga natyra, krahasuar me pozicionin e punës dhe kriteret e kandidatëve të tjerë të administratës publike.

Nga AKSHI të merren masa që në rregullore të përcaktohen qartë kriteret për rekrutimin e personelit, për të përshtatur pozicionin e punës me kualifikimin arsimor, gjë e cila ndikon në cilësinë dhe mbarëvajtjen e punës. Pozicionet e punës të cilët drejtohen nga punonjës të cilët nuk kanë kualifikimin e duhur arsimor sipas specifikës që kërkon pozicioni i punës, si: Drejtor i Drejtorisë së të Dhënave Shtetërore, (kualifikimi arsimor inxhinier nafte), Drejtor i Drejtorisë së Portalit Qeveritar (kualifikimi arsimor-jurist), apo përgjegjës sektori, të cilët kanë një vjetërsi në punë nga 10 muaj deri në dy vjet, duhet të rishikohen dhe zëvendësohen me personat me kualifikimin e duhur arsimor.

Menjëherë

11. Nga auditimi mbi respektimin e dispozitave ligjore për krijimin e fondit të veçantë, dhënien e shpërblimeve për rezultatet në punë, ndihma për fatkeqësi etj., konstatohet se Fondi i veçantë është përdorur në zbatim të VKM nr.369, datë 13.06.2007 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë”, të ndryshuar me VKM nr.929, datë 17.11.2010 dhe VKM nr.826, datë 05.12.2011, duke u kryer pagesë për largime nga puna për 7 punonjës, sipas Urdhrit nr.66 datë 11.04.2014, në shumën 1,760 mijë lekë. Nga auditimi i dosjes së lirimit të 7 punonjësve rezulton se ndërprerja e marrëdhënieve të punës në mënyrë të njëanshme nga Drejtori i Përgjithshëm i AKSHI-t është bërë në kundërshtim me Kodin e Punës dhe kontratën individuale të punës me punonjësit, duke i ndërprerë marrëdhëniet e punës në mënyrë të menjëhershme, referuar Urdhrave të lirimit të cilat mbajnë datën 21.02.2014, pa respektuar parashikimet në nenin 143 dhe 144 të Kodit të Punës si dhe *nenit 15 të Kontratës individuale të punës*, njoftimin dhe arsyen e lirimit të tyre në një periudhë 1-3 mujore para këtij vendimi. Përsa më sipër, nga veprimet në arbitraritet të kompetencave të ushtrimit të detyrës shtetërore krijojnë premisat për dëm për Buxhetin e Shtetit për sa kohë këto vendime janë të ankimueshme në Gjykatë (*trajtuar më hollësisht në faqen 42-47 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër është rekomanduar:

Nga Titullari i Institucionit, të merren masa për të mos përsëritur rastet e ndërprerjeve të marrëdhënieve të punës në mënyrë të njëanshme pa zbatuar kërkesat ligjore, por të ndiqen të gjitha veprimet proceduriale në përputhje me kërkesat e Kodit të Punës dhe kontratën individuale të punës me punonjësit, për të eliminuar riskun e kostove shtesë nga vendimet gjyqësore.

Menjëherë

12. Nga auditimi i funksionimit të sistemeve të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit (MFK) për vitet 2014-2015, rezultoi se menaxhimi financiar dhe sistemi i kontrollit brendshëm në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, nuk ka funksionuar, pasi ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin nuk është zbatuar nga të gjithë hallkat e njësisë, ndërsa punonjësit nuk kanë njohuri të plota mbi ligjin dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë mundur të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në këtë institucion.

Për vitin 2014, është hartuar dhe miratuar Deklarata e Misionit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, por nuk ka një Strategji të plotë, e cila të përmbajë objektivat strategjike, prioritetet e institucionit dhe planet e veprimit, për arritjen e qëllimeve strategjike, me persona konkretë përgjegjës për realizimin e tyre.

Nuk janë hartuar gjurmët e auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emëtuara nga Ministria e Financave. Këto gjurmë të proceseve dhe përgjegjësive, nuk janë identifikuar me emërtimin “Lista e proceseve të punës”, nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme.

Nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, monitorimin e kontroleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave, pra nuk është hartuar një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të risqeve dhe adresimi i personave përgjegjës për çdo risk, i cili duhet të plotësohet, përditësohet në vazhdimësi, si dhe të dërgohet ky regjistër në Kryeministri dhe në Ministrinë e Financave, konform përcaktimeve të kreut III “Identifikimi i risqeve” të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.

Struktura dhe organika e miratuar me 45 punonjës në vitin 2014 dhe me 95 punonjës në vitin 2015, nuk ka garantuar realizimin e të gjitha detyrave të AKSHI dhe ndarjen e detyrave funksionale, hierarkinë dhe rregullat përkatëse për të drejtat, përgjegjësitë, shmangien e konfliktit, linjat e raportimit, sepse ashtu siç është konstatuar edhe në auditimin e administrimit të vlerave materiale, projekt buxhetin dhe realizimin e tij, pasqyrat financiare dhe gjithë shërbimet e tjera në magazinë, protokoll dhe burimet njerëzore i mbulon një sektor me 2 specialistë, duke krijuar vështirësi në hyrje dalje të aseteve dhe ka krijuar konflikt interesi, sepse magazinën arkën e institucionit, protokollin dhe asistenten e Drejtorit të Përgjithshëm, e mbulon një specialiste.

Sipas kërkesave të Ligjit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS), koordinatori i riskut dhe strategjia e menaxhimit të riskut, për identifikimin, analizimin dhe kontrollin e risqeve që mund të vënë në rrezik përmbushjen e objektivave të AKSHI-t, është krijuar në fund të vitit 2015, gjë e cila ka sjellë mangësi e shkelje në realizimin e objektivave dhe miradministrimin e fondeve buxhetore dhe aseteve materiale të institucionit.

Lidhur me delegimin e kompetencave, nëpunësi autorizues dhe nëpunësi zbatues dhe menaxherë të tjerë të njësisë, nuk kanë rregulla të brendshme të miratuara nga titullari, të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre (*trajtuar më hollësisht në faqen 155-171, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër është rekomanduar:

Titullari i institucionit, për të rritur përgjegjshmërinë në menaxhimin e riskut, në drejtim të identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut, të marrë masat e duhura për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut e cila duhet të përditësohet rregullisht, të paktën 1 herë në 3 vjet, si

dhe sa herë kur mjedisi i riskut pëson ndryshime të rëndësishme, duke bërë kështu vlerësimin dhe kontrollin e risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë.

Të marrë masat e duhura për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve dhe të hartojë kërkesa specifike për trajnimin e punonjësve të administratës, për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe manualin të dalë në zbatim të tij. Në mënyrë të veçantë për menaxhimin e riskut pasi, menaxherët e njësisë nuk zotërojnë informacion për qëllimet dhe rëndësinë e menaxhimit financiar dhe kontrollin dhe se, ligji për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk ka funksionuar si duhet në këtë institucion. Gjithashtu, institucioni të hartojë një procedurë për mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve dhe analizën e tyre, si dhe të bëjë dhe vlerësimin e punës së punonjësve.

Për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të merren masat për të hartuar gjurmët e auditimit, ku të përfshihen proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve me të rëndësishme.

Për të realizuar objektivat dhe ndarjen e detyrave funksionale, hierarkinë dhe rregullat përkatëse për të drejtat, përgjegjësitë, shmangien e konfliktit, linjat e raportimit dhe administrimi i vlerave materiale, në hartimin e projekt buxhetin dhe realizimin e tij, pasqyrat financiare dhe gjithë shërbimet e tjera të lidhura me raportimin financiar, të plotësohet organika me specialistë të fushës.

Brenda 9/mujorit 2016.

13. Nga auditimi i procedurave të prokurimit, ku vetëm për periudhën 2014-2015 janë realizuar 78 objekte, që arrijnë vlerën 2,294,289 mijë lekë (rreth 17 milion Euro), është konstatuar se në organikën e institucionit mungon sektori i prokurimeve. Gjithashtu nga ana e titullarit të institucionit nuk është ngritur në fillim të vitit 2014 Njësia e Prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007. Nga vlerësimi i standardeve të TIK-ut për administratën shtetërore për vitin 2014 dhe 2015, rezultoi se AKSHI nuk i referohet asnjë standardi ndërkombëtar për miratimin e specifikimeve teknike. Nuk ekziston asnjë procedurë/rregullore në lidhje me miratimin e këtyre standardeve. Për të dy vitet nuk është mbajtur asnjë dokument vërtetues mbi takimet e zhvilluara, me pjesëmarrësit, ndryshimet e kërkuara nga ata, çka do të thotë që miratimi i standardeve është një formalitet që përsëritet pa treguar asnjë interes në miratimin të tyre, për të qenë sa më koherent me teknologjinë për çmimin më optimal të mundshëm (*trajtuar më hollësisht në faqen 76-148 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

Për sa më sipër është rekomanduar:

Titullari i AKSHI-t, nisur nga ngarkesa dhe vlerat e konsiderueshme që prokurohet në këtë Institucion, të marrë masat që në strukturën organizative të institucionit, të ngrihet një sektor, i cili të mbulojë problemet e prokurimit, në përbërje të të cilit të jenë specialistë të fushës. Gjithashtu, në zbatim të bazës ligjore të prokurimeve, të ngrihet Njësia e Prokurimit në fillim të vitit ushtrimor.

Në vijimësi

Nga AKSHI të punohet për të hartuar një rregullore me procedurat dhe metodologjitë që përdoren për specifikimet teknike të TIK për administratën shtetërore, ku të përcaktohen qartë të gjithë elementët që do të hyjnë në analizë përpara çdo miratimi, si dhe të gjithë dokumentacionin që do të mbahet prej fillimit të shqyrtimit të tyre deri në takimet përmbyllëse. Të kërkohet nga AKSHI përfshirja e me shumë aktorëve/faktorëve në diskutime, të cilët mund të jenë drejtues të drejtorive apo departamenteve të TIK të institucioneve publike. Të përcaktohet procedura e marrjes në analizë i përsëritjeve/kërkesave që vijnë për miratim, për të cilat lind e nevojshme standardizimi i tyre.

Të sanksionohet kërkesa për marrjen e eksperiencave nga subjektet të cilat kanë një apo më shumë kontrata shërbimi me AKSHI-n dhe institucione të tjera publike. Të merren në konsideratë dhe standardet e administratave shtetërore të vendeve evropiane, duke filluar me vendet me të cilat AKSHI ka marrëveshje bashkëpunimi, për të arritur në produktin më të mirë me kosto më të ulët.

Menjëherë

C.1 MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Nga auditimi i procedurës së prokurimit “Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE”, rezulton se KVO ka bërë me të pa drejtë skualifikimin e BOE “C” shpk & “T S” shpk dhe ka kualifikuar OE “..” shpk, i cili nuk plotëson kërkesat e veçanta për kualifikim, në kundërshtim me kreun V, pika 4/ç, të VKM nr. 1, datë 10.01.2007, me arsyetimin si më poshtë:

- BOE “C..” shpk & “T..” shpk - Oferta teknike e propozuar nga bashkimi i operatorëve C.. dhe T.. nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara nga Autoriteti Kontraktor sipas kërkesës për sqarim të dërguar më dt. 10.03.2014 Nr. Prot. 843, përgjigjes së kthyer më datë 11.06.2014 Nr. Prot. 43 si dhe vlerësimit teknik të bashkëngjitur”. Nga verifikimi i dokumenteve të hedhur në sistem dhe krahasimit të tyre me Raportin Përmbledhës të prokurimit me nr. 997 prot, date 07.07.2014, të KVO-së, rezulton se BOE “C..” shpk & “T..” shpk ka paraqitur pajisjen HP Proliant DL 380 p Generation8 Server me të gjitha kërkesat dhe elementët teknikë që kërkohen në dokumentet e tenderit. Sipas vlerësimit të KVO-së, kjo ofertë nuk është pranuar pasi “... *Oferta teknike nga bashkimi i operatorëve “C” shpk & “T..” shpk nuk përmbush specifikimet teknike të kërkuara nga AK sipas kërkesës për sqarim të dërguar me nr. 843 Prot, datë 10.03.2014, përgjigjes se kthyer me nr. 43 prot., datë 11.06.2014 dhe vlerësimit teknik bashkëngjitur*”

Në shkresën e bërë nga KVO, drejtuar BOE “C..” shpk & “T..” shpk, me nr. 843, datë 10.06.2014, janë kërkuar “... *sqarime për produktet e ofruara nga ju, deri në datën 11.06.2014*”. Pra, si në këtë shkresë, ashtu edhe në raportin përmbledhës të prokurimit, nuk është specifikuar se çfarë konkretisht mungon, apo është e paqartë në ofertën e BOE “C..” shpk & “T..” shpk.

Shkresa e sjellë nga ky BOE, sqaron mënyrën e licencimit dhe sasinë e licencave (12 CPU, jo 8 CPU) dhe ky fakt nuk duhej të ishte skualifikues, pasi kriteri ishte për 8 CPU. Fakti që në propozimin teknik të këtij BOE është cituar “*Përdorimi i 2 x Intel® Xeon® E5-2643 v2 (3.5GHz/6-core/25MB/8.0GT-s QPI/130W) për çdo server, kursen gjysmën e sasisë së licencave te Oracle!*”, tregon se oferta e paraqitur për këtë kriter tejkalon atë të kërkuar në KVK.

Nga sa sipër, edhe pse në modifikimin e dokumenteve të tenderit, AK ka pranuar opsionin “ekuivalente” për produktin e kërkuar, KVO e ka vlerësuar ofertën teknike të BOE “C..” shpk & “T..” shpk për detajet dhe jo si një produkt i integruar, duke bërë skualifikimin e ofertës më të

ulët. Citimi në observacion i nenit 51 të LPP-së është i drejtë dhe në zbatim të këtij neni, KVO nuk duhet të kishte lejuar modifikimin e ofertës nga BOE “C..” shpk & “T..” shpk, i cili me përgjigjen e bërë kërkesës së AK, në fakt ka bërë ndryshimin e ofertës teknike.

Gjithashtu, nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur nga ana e OE fitues “I..” shpk, konstatohet se nuk plotësohet pika 2.3 e KVK “Kapaciteti teknik” sipas të cilës “... OE duhet të ketë të paktën 6 (gjashtë) personel teknik të kombinuar dhe që të jenë të certifikuar në lidhje me teknologjinë që ofron në ofertën teknike për realizimin sipas standardeve ndërkombëtare të objektit kontratë prokurimi, ...”. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se kjo shoqëri ka paraqitur 5 (pesë) personel teknik gjithsej.

Nga sa sipër, KVO duhet të kishte kualifikuar BOE “C..” shpk & “T..” shpk si ofertë të vlefshme dhe të kishte skualifikuar OE “I..” shpk për mosplotësim të kërkesave të veçanta për kualifikim, bazuar në kreun V, pika 4/ç, ku citohet “...Komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat ligjore, administrative e kualifikuese, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, apo që nuk janë me çmim anomalisht të ulët, sipas formulës së përcaktuar në rregullat e prokurimit publik” (trajtuar më hollësisht në faqen 79-91 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër është rekomanduar:

Të arkëtohet vlera **10,962,520 lekë**, përkatësisht nga E.Z., V.P. dhe Y.Ç., me cilësinë e anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për kualifikimin dhe skualifikimin në kundërshtim me bazën ligjore të prokurimeve.

Menjëherë

2. Nga auditimi i procedurës “Mirëmbajtja e Sistemit Elektrik, Sistemit të Zjarrit, Sistemit CCTV, Sistemit të Access Control, sistemit BMS, sistemit të kondicionimit dhe shërbimi i pastrimit të Qendrës të të Dhënave Qeveritare”, rezultoi se në këtë Autoritet Kontraktor ka patur një kontratë, me nr. 1135/1, datë 13.12.2010, sipas të cilës duhet të kryeshin shërbimet e mësipërme, e cila përfundon në 11.03.2016, fakt që duhet të kishte shmangur kryerjen e kësaj procedure. Rezulton të ketë mbivendosje kohore në dy objekte prokurimi, për të njëjtin qëllim, për rreth 18 muaj. Nisur nga oferta e OE fitues, AK ka paguar shërbimet periodike në ambientet e Data Center, ndërkohë që këto shërbime ishin nën kontratë, në vlerën 10,827 mijë lekë (601,500 lekë/muaj (oferta e kontratës nr. 1383, datë 29.09.2014) x 18 muaj) (trajtuar më hollësisht në faqen 98- 106 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër është rekomanduar:

- Propozuar AK për verifikim nga strukturat e brendshme te vlerës prej **10,827,000 lekë**, nga mbivendosja në kohë e dy objekteve prokurimi për të njëjtin qëllim.

Menjëherë

3. Nga auditimi i zbatimit të kontratës “Lidhja e sistemit në Platformën Qeveritare të Ndërveprimit dhe Shtimi i Shërbimeve të reja në portalin qeveritar e-Albania” rezulton se për një shërbim me vlerë 960,000 lekë (“Aplikim për njohje diplome”) ka vonesë të pajustificuar të përfundimit të realizimit, për të cilin AK duhet të kishte mbajtur penalitet në zbatim të nenit 20 të Kontratës, pika 20.1/b, në masën 2/1000 të pjesës së mbetur të kontratës. Nga llogaritja, del që

ky penalitet duhet të ishte mbajtur në shumën 97,920 lekë (960,000 lekë x 0.002 x 51 ditë) (trajtuar më hollësisht në faqen 76-79 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Për sa më sipër është rekomanduar:

AKSHI të ndërmarrë të gjitha hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës prej **97,920 lekë** nga OE “...” shpk, si penalitet për mosrealizimin në kohët të shërbimit të kërkuar, në zbatim të nenit 20.1/b të Kontratës.

Menjëherë

5. Nga auditimi i pagesave të kryera për kualifikimet shkencore (tituj shkencor dhe post-master) bazuar në VKM nr. 52, datë 01.02.2012, “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 545, datë 11.08.2011, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave nëpunësve civilë /nëpunësve, Zëvendës Ministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e Ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa Institucione të pavarura, Institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, Institucione në varësi të Ministrave të linjës dhe Administratën e Prefektit”, të ndryshuar”, u konstatua se, në listë pagesat e vitit 2014 ka filluar të kryhet pagesa për titullin shkencor “Doktor”, titullarit të Agjencisë, e cila është bërë me miratim të Sekretarit Përgjithshëm të KM pas miratimit të Departamentit të Administratës Publike, pavarësisht se në kategorizimin dhe kualifikimet e kërkuara për Titullarët e institucionit nuk kërkohet titull shkencor. Referuar shkresave të miratimit për pagesën e titullit datë 13.02.2014 dhe urdhrit të brendshëm nr.54 datë 27.02.2014, rezulton se Drejtori Përgjithshëm i AKSHI-t, ka urdhëruar fillimin e pagesës së doktoraturës me efekt financiar paraveprues duke filluar pagimin e titullit nga muaji Tetor 2013 kohë në të cilën është dhe emëruar në detyrën që mban (datë 07.10.2013), si dhe miratimit të saj nga Departamenti i Administratës Publike, duke përfituar në mënyrë të padrejtë shumën bruto prej **75,454** lekë sipas urdhër shpenzimit nr.30 datë 27.02.2014 shkurt (trajtuar më hollësisht në faqen 46, të Raport Përfundimtar Auditimit).

Për sa më sipër është rekomanduar:

Të bëhet arkëtimi i vlerës prej **75,454 lekë** nga Titullari i institucionit znj. ■■■ duke përfituar në mënyrë të padrejtë shumën në kundërshtim me miratimin nga Departamenti i Administratës Publike, me efekt financiar paraveprues duke filluar pagimin e titullit nga muaji Tetor 2013 kohë në të cilën është dhe emëruar në detyrën që mban (datë 07.10.2013), si dhe miratimit të saj nga Departamenti i Administratës Publike (datë 13.02.2014).

Menjëherë

C.2 FONDE TË SHPENZUARA PA EKONOMICITET

Nga auditimi u konstatuan raste të realizimit të procedurave të prokurimit sipas kërkesa ligjore, por në mungesë të një kujdesi për të analizuar nivelin real të fondit limit për të siguruar këto lloj shërbimesh/mallrash. Si pasojë u konstatua një nivel i ulët ekonomikiteti në përdorimin e fondeve të prokuruar gjatë periudhës së auditimit nga ky institucion dhe që arrijnë në një total prej rreth 132,511 mijë lekë. Kështu po cilësojmë disa prej tyre:

1. Për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Platforma qeveritare e ndërveprimit. Riinxhinierim e modernizim të 51 proceseve të punës G2G, zgjerim me 21 shërbime të reja

elektronike G2G, G2C dhe G2B dhe shtimi i 6 shërbimeve të reja në portalin qeveritar e-albania.al”, në termat e referencës është kërkuar të jepet ofertë për “*Shërbime të reja elektronike, 11 DIS, 15 konfigurime DIS*” dhe “*Mirëmbajtje vjetore të sistemit të ndërveprimit ESB +32 DIS me gjithë të rejat që do të shtohen, trajnim*”, ndërsa nga ana operatorëve ekonomikë të ftuar për të paraqitur oferta, janë sjellë oferta përpikmërisht sipas të njëjtës strukturë, por e ndryshme nga ajo e paraqitur në Termat e Referencës nga AK, gjë që tregon se këto oferta janë bërë nga e njëjta dorë dhe nuk është analizuar nga grupi i punës. Konstatohet se për të realizuar këtë objekt, janë planifikuar gjithsej 313,258 mijë lekë pa tvsh, nga të cilat për implementimin e shërbimeve të reja 78,466 mijë lekë pa tvsh, ndërsa për mirëmbajtjen vjetore të shërbimeve, DIS-eve dhe infrastrukturës GG janë planifikuar 117,396 mijë lekë pa tvsh (nga të cilat 55,606 mijë leke mirëmbajtje vjetore për shërbimet. Nisur nga ofertat e tregut të marra nga ky AK për përlogaritjen e fondit limit për objektin “Lidhja e sistemeve në platformën qeveritare të ndërveprimit dhe shtimi i shërbimeve të reja në portalin qeveritar e-Albania”, për të cilën është bërë vlerësimi i ofertave mesatare, konstatohet se në shkresën nr. 540, datë 25.04.2014 të grupit të punës së ngritur për këtë qëllim, mirëmbajtja për dy vjet e HW dhe SW është 23,026,171 lekë, ndërsa mirëmbajtja dyvjetore e platformës elektronike GG është 78,684,000 lekë. Nga rilloaritja, fondi limit i këtij objekti do të ishte 291,388,171 lekë pa tvsh, (78.466.000 implementimi + 2 x 55,606,000 lekë mirëmbajtje për këtë implementim + 23,026,171 lekë mirëmbajtje për SW dhe HW + 78,684,000 lekë për mirëmbajtjen e platformës GG) ose 21,869,637 lekë pa tvsh më pak se fondi limit i prokuruar.

2. Për realizimin e procedurës së me objekt “Shtimi i shërbimeve të reja elektronike në Portalin Qeveritar e-Albania”, pasi pas marrjes së ofertave është bërë mesatare e thjeshtë aritmetike, pa analizë teknike të zërave të ofertuar, duke përlogaritur mirëmbajtjen vjetore në masën 29.7 % të vlerës së implementimit të shërbimit, kur sipas eksperiencave të mëparshme të vet institucionit, mirëmbajtja vjetore e shërbimeve apo përmirësimit të shërbimeve është rreth 20 %. Nga ky grup pune, pas marrjes së ofertave, është bërë mesatarja aritmetike e ofertave të paraqitura dhe është përlogaritur fondi limit në vlerën 196,825 mijë lekë pa tvsh, nga të cilat 89,925 mijë lekë për implementim e shërbimeve dhe 26,725 mijë lekë mirëmbajtje vjetore, ose 29.7% të vlerës së implementimit të shërbimit si mirëmbajtje vjetore. Në dosje nuk administrohet asnjë dokument ku të bëhet analiza e zërave të ofertuar edhe sipas eksperiencave të mëparshme të vet institucionit, në të cilat mirëmbajtja vjetore e shërbimeve apo përmirësimit të shërbimeve është rreth 20 %. Përlogaritja e fondit limit nuk është bërë në bazë të eksperiencave të mëparshme të vet institucionit dhe nuk ka analizë teknike të zërave që do të prokurohen. Rezulton që nëse do të merrej në konsideratë eksperiencia e mëparshme e vet institucionit do të kishim një fondi limit në vlerë 34,960,000 lekë më të ulët.

3. Për realizimin e procedurës me objekt “Shtimi i 209 shërbimeve elektronike për 18 institucione” konstatohet se në Urdhrin nr.764 prot, datë 08.05.2015 të titullarit të Autoritetit Kontraktor (AK) citohet që “*Përlogaritja e fondit limit të bëhet duke iu referuar testimit të tregut, eksperiencave të ngjashme dhe/ose publikimeve zyrtare, konform legjislacionit në fuqi*”. Grupi i punës, ka bërë përlogaritjen e fondit limit bazuar vetëm në testimin e tregut dhe pas marrjes së tre ofertave ofertave, është bërë mesatarja aritmetike e ofertave të paraqitura dhe është përlogaritur fondi limit në vlerën 316,178 mijë lekë pa tvsh, nga të cilat 263,556 mijë lekë për implementim e shërbimeve dhe 52,622 mijë lekë mirëmbajtje për 4 vjet. Në dosje nuk administrohet asnjë dokument ku të bëhet analiza e zërave të ofertuar, bazuar edhe në eksperiencat e mëparshme të vet institucionit, pasi në prill të po këtij viti është lidhur një kontratë e ngjashme me një nga ofertuesit e mësipërm dhe oferta e dhënë nga ky ofertues për

shtimin e një shërbimi është mesatarisht 934,831 lekë pa tvsh (83,200,000 lekë : 89 shërbime). Ky fakt nuk është marrë në konsideratë, në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, sipas të cilit “Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave... a) çmimet e tregut; ose/dhe b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore;...”. Rezulton që nëse do të merrej në konsideratë eksperiencia e mëparshme e vet institucionit do të kishim një fond limit në vlerë 68,175,780 lekë më të ulët.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Autoriteti Kontraktor, të marrë të masa për të eliminuar procedurat formale të llogaritjes së fondit limit, lënien e tyre në varësi të ofertave të marra nga operatorët e ndryshëm ekonomikë, të cilët diktojnë edhe çmimet e shërbimeve dhe të bëjë analizë të mirëfilltë teknike të çmimeve të ofertuara, duke konsideruar edhe eksperiencat e mëparshme të institucionit, në mënyrë që fondet e Buxhetit të Shtetit të alokuara për investimet në fushën e shërbimit të informacionit, të përdoren më ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

D.1. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” i rekomandoj e Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Largim nga Detyra”, në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës, për personat si më poshtë:

1. ■■■, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Portalit e-Albania, pasi:

a. Me cilësinë e kryetarit të KVO-së, në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE”, KVO pas shqyrtimit të ofertave, ka shpallur fitues OE “■■■ shpk, dhe ka refuzuar padrejtësisht ofertën e BOE ■■■ shpk & “■■■.” shpk, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 10,962,520 lekë.

Me cilësinë e anëtarit të grupi për miratimin e projekteve, për hartimin e projekteve si nga ana teknike dhe financiare pa respektuar dhe kryer asnjë hap ligjor lidhur me studimin e tregut, duke përcaktuar vlerën e tyre nga ofertat e tregut me një mesatare aritmetike të thjeshtë, pa asnjë lloj analize.

2. ■■■, me detyrë drejtor i Drejtorisë së Kërkimit dhe Zhvillimit e-Gov, pasi:

a. Me cilësinë e anëtarit të KVO-së, në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE”, pasi KVO, ka shpallur fitues OE ■■■ shpk, dhe ka refuzuar padrejtësisht ofertën e BOE “■■■” shpk & “■■■.” shpk, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 10,962,520 lekë.

b. Me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, për realizimin e procedurës së me objekt “Blerje software për përpunimin e të dhënave, Arshiva e digjitalizuar dhe pajisje skanimi, server + pajisje depoz të dhëna Arsh dig”, nuk ka analizuar ofertat e marra nga studimi i tregut, ku mesatarja aritmetike e vlerave të ofertuara është përpikmërisht e njëjtë me të gjitha vlerat e ofertuara nga OE ■■■ shpk.

c. Me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së me objekt “Sistemi multifunksional i qendëruar i lejeve të ndërtimit”, pasi edhe pse sipas specifikimeve teknike, në kapitullin 8 “Mirëmbajtja” citohet që “...vlera e mirëmbajtjes vjetore është 20% e projektit...”, vlera e mirëmbajtjes vjetore është llogaritur me 21.11% të vlerës së implementimit, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 880,000 lekë në vit .

3. Y.Ç. me detyrë Drejtorisë së Bazës së të Dhënave Shtetërore, pasi:

a. Me cilësinë e kryetarit të KVO-së, në procedurën e prokurimit me objekt: “Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE”, pasi KVO, ka shpallur fitues OE “**■** shpk_ dhe ka refuzuar padrejtësisht ofertën e BOE “**■** shpk & “**■**” shpk, duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 10,962,520 lekë.

b. Me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe përlogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Platforma qeveritare e ndërveprimit. Riinxhinierim e modernizim të 51 proceseve të punës G2G, zgjerim me 21 shërbime të reja elektronike G2G, G2C dhe G2B dhe shtimi i 6 shërbimeve të reja në portalin qeveritar e-albania.al”, pasi në termat e referencës është kërkuar të jepet ofertë për “Shërbime të reja elektronike, 11 DIS, 15 konfigurime DIS” dhe “Mirëmbajtje vjetore të sistemit të ndërveprimit ESB +32 DIS me gjithë të rejat që do të shtohen, trajnim”, ndërsa nga ana operatorëve ekonomikë të ftuar për të paraqitur oferta, janë sjellë oferta përpikmërisht sipas të njëjtës strukturë, por e ndryshme nga ajo e paraqitur në Termat e Referencës nga AK, fakt që nuk është analizuar nga grupi i punës

c. Me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së me objekt “Shtimi i shërbimeve të reja elektronike në Portalin Qeveritar e-Albania”, pasi pas marrjes së ofertave është bërë mesatare e thjeshtë aritmetike, pa analizë teknike të zërave të ofertuar, duke përlogaritur mirëmbajtjen vjetore në masën 29 % të vlerës së implementimit të shërbimit, kur sipas eksperiencave të mëparshme të vet institucionit, mirëmbajtja vjetore e shërbimeve apo përmirësimit të shërbimeve është rreth 20 %.

4. D.SH., me detyrë përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Investimeve në TIK, me cilësinë e hartuesit të specifikimeve teknike në procedurat e prokurimit me blerje të vogla “Marrje mjeti me qera”, pasi u konstatua se në procedurat e prokurimit me blerje të vogla, me Urdhër Prokurimi nr.31 datë 23.09.2015 është prokuruar fondi limit “Marrje mjeti me qera”. Referuar specifikimeve teknike konstatohet se është kërkuar: *Cilindrata (min-max) – 2,500 – 3,500, Ngjyra - e zezë, Mbyllje e centralizuar + komandim në distancë, Minimumi 8 airbag, Sediljet me ngrohje, Sediljet lëkurë e plotë, Timoni me lëkurë dhe komanda, Pilot automatik, Sensor parkimi para e mbrapa, Kambio automatike, Kompjuter bordi dhe navigator të pajisur me hartën e Europës, Klima automatike me 2 zona, Radio cd mp3, Aux bagazhier cd/dvd, Pasqyra me sinjale dhe me palosje, Drita mjegulle bi-Xenon me larje, ngrohje e asistent kthese, Disqe alumini, Xhamat e errëta mbrapa (nga fabrika), Xhamat elektrike, Shina mbi tavan.* Nga sa sipër, specifikimet teknike janë hartuar tejet të ekzagjeruara dhe diskriminuese, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Ndërsa në procedurën “Blerje akses kontrolli dhe kamerë për sistem sigurie ekzistues”, janë vendosur si kritere të veçanta kualifikimi: kontrata të ngjashme me minimumi 40% të fondit

limit; ISO 9001:2008 për sistemin e menaxhimit të cilësisë; ISO 27001:2005 Për sistemin e menaxhimit të sigurisë së Informacionit; OHSAS 18001:2007 (për kushtet e sigurisë dhe të shëndetit të punonjësve); Një inxhinier elektrik me diplomë 5-vjeçare ose ekuivalente me vjetërsi të paktën 3 vjet dhe të jetë jo më pak se një vit i punësuar tek OE, për sistemin e UPS-ve, për të cilat OE duhet të paraqesë Diplomën, CV, Certifikata nga prodhuesi Schneider Electric ose ekuivalent dhe listëpagesat për 12 muajt e fundit

Në procedurën “*Blerje pajisje gjeneratori dhe elektrike*”, janë vendosur si kritere të veçanta kualifikimi: kontrata të ngjashme me minimumi 40% të fondit limit; ISO 9001:2008 për sistemin e menaxhimit të cilësisë; Një inxhinier elektrik me diplomë dhe të jetë me certifikatë ose vërtetim nga një prodhues gjeneratorësh për mirëmbajtje.

Në procedurën “*Blerje pjesë këmbimi UPS*”, janë vendosur si kritere të veçanta kualifikimi: MAF nga prodhuesi Pelco by Schneider Electric, ose ekuivalente, si pasojë e sistemit ekzistues; ISO 9001:2008 për sistemin e menaxhimit të cilësisë; OHSAS 18001:2007 (për kushtet e sigurisë dhe të shëndetit të punonjësve); Një inxhinier elektrik me diplomë 5-vjeçare ose ekuivalente me vjetërsi të paktën 3 vjet dhe të jetë jo më pak se një vit i punësuar tek OE, i certifikuar për sistemin e kamerave dhe akses kontrollit, për të cilat OE duhet të paraqesë Diplomën, CV, Certifikatat për sistemin e kamerave dhe akses kontrollit dhe listëpagesat për 12 muajt e fundit

Në të gjitha rastet e cituara kriteret e përcaktuara janë paracaktuese për një operator ekonomik duke ngushtuar konkurrencën dhe duke ndikuar indirekt në efektivitetin e prokurimit të realizuar.

D.2. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” i rekomandoj e Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me paralajmërim” deri “Largim nga detyra”, në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës për 3 (tre) persona, si më poshtë:

1. ■■■■■ me detyrë drejtore e Drejtorisë së Sistemeve e-Gov:

a. Me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Platforma qeveritare e ndërveprimit. Riinxhinierim e modernizim të 51 proceseve të punës G2G, zgjerim me 21 shërbime të reja elektronike G2G, G2C dhe G2B dhe shtimi i 6 shërbimeve të reja në portalin qeveritar e-albania.al”, pasi në termat e referencës është kërkuar të jepet ofertë për “Shërbime të reja elektronike, 11 DIS, 15 konfigurime DIS” dhe “Mirëmbajtje vjetore të sistemit të ndërveprimit ESB +32 DIS me gjithë të rejat që do të shtohen, trajnim”, ndërsa nga ana operatorëve ekonomikë të ftuar për të paraqitur oferta, janë sjellë oferta përpikmërisht sipas të njëjtës strukturë, por e ndryshme nga ajo e paraqitur në Termat e Referencës nga AK, të cilat nuk janë analizuar nga grupi i punës

b. Me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së me objekt: “Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE”. Ky grup pune, ka kërkuar oferta katër operatorëve ekonomikë, me qëllim përlllogaritjen e fondit limit, në të cilat citohet që bashkëlidhur këtyre shkresave janë vendosur specifikimet teknike. Por edhe pse këto shkresa dhe specifikimet teknike, nuk janë shoqëruar me një preventiv memec për marrjen e ofertave, nga operatorët ekonomikë janë paraqitur oferta saktësisht sipas të njëjtës strukturë, e cila është e njëjtë edhe me strukturën e

preventivit të hedhur më vonë në sistemin elektronik të APP-së. Kjo tregon që ofertat janë bërë nga e njëjta dorë dhe përlllogaritja e fondit limit është fiktive dhe e paanalizuar nga grupi i punës.

2. ■■■■■ me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Përditësimit të Shërbimeve të Portalit e-Albania,

a. Me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për përgatitjen e dokumentacionit teknik dhe përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Platforma qeveritare e ndërveprimit. Riinxhinierim e modernizim të 51 proceseve të punës G2G, zgjerim me 21 shërbime të reja elektronike G2G, G2C dhe G2B dhe shtimi i 6 shërbimeve të reja në portalin qeveritar e-albania.al”, pasi në termat e referencës është kërkuar të jepet ofertë për “*Shërbime të reja elektronike, 11 DIS, 15 konfigurime DIS*” dhe “*Mirëmbajtje vjetore të sistemit të ndërveprimit ESB +32 DIS me gjithë të rejat që do të shtohen, trajnim*”, ndërsa nga ana operatorëve ekonomikë të ftuar për të paraqitur oferta, janë sjellë oferta përpikmërisht sipas të njëjtës strukturë, por e ndryshme nga ajo e paraqitur në Termat e Referencës nga AK, të cilat nuk janë analizuar nga grupi i punës.

b. Me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së me objekt: “Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE”. Ky grup pune, ka kërkuar oferta katër operatorëve ekonomikë, me qëllim përlllogaritjen e fondit limit, në të cilat citohet që bashkëlidhur këtyre shkresave janë vendosur specifikimet teknike. Por edhe pse këto shkresa dhe specifikimet teknike, nuk janë shoqëruar me një preventiv memec për marrjen e ofertave, nga operatorët ekonomikë janë paraqitur oferta saktësisht sipas të njëjtës strukturë, e cila është e njëjtë edhe me strukturën e preventivit të hedhur më vonë në sistemin elektronik të APP-së. Kjo tregon që ofertat janë bërë nga e njëjta dorë dhe përlllogaritja e fondit limit është fiktive dhe e paanalizuar nga grupi i punës.

c. Me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së me objekt “Përmirësimi i portalit qeveritar e-albania”, pasi në specifikimet teknike në pikën 8 “Sasia e nevojshme për prokurim”, faqe 28-29, gjenden 11 zëra, përfshirë edhe mirëmbajtjen (SLA) për 4 vjet. Nga auditimi i dokumentacionit për përlllogaritjen e fondit limit të administruar në dosje, rezulton se të tre OE kanë dhënë ofertë për 10 zëra (përfshi mirëmbajtjen) dhe e kanë dhënë ofertën sipas të njëjtës strukturë (dmth, të tre me ofertat me 10 zëra). Ky veprim tregon se përlllogaritja e fondit limit nga grupi i punës është bërë në mënyrë fiktive dhe fondi limit i dalë nga ky akt, nuk është real.

d. Me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së me objekt “Shtimi i shërbimeve të reja elektronike në Portalin Qeveritar e-Albania”. Nga ky grup pune, pas marrjes së ofertave, është bërë mesatarja aritmetike e ofertave të paraqitura dhe është përlllogaritur fondi limit në vlerën 196,825,000 lekë pa tvsh, nga të cilat 89,925,000 lekë për implementim e shërbimeve dhe 26,725,000 lekë mirëmbajtje vjetore, ose 29.7% të vlerës së implementimit të shërbimit si mirëmbajtje vjetore. Në dosje nuk administrohet asnjë dokument ku të bëhet analiza e zërave të ofertuar edhe sipas eksperiencave të mëparshme të vet institucionit, në të cilat mirëmbajtja vjetore e shërbimeve apo përmirësimit të shërbimeve është rreth 20 %.

e. Me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së me objekt “Shtimi i shërbimeve të reja elektronike në Portalin Qeveritar e-Albania”, pasi pas marrjes së ofertave është bërë mesatare e thjeshtë aritmetike, pa analizë teknike të zërave të ofertuar, duke përlllogaritur mirëmbajtjen vjetore në

masën 29 % të vlerës së implementimit të shërbimit, kur sipas eksperiencave të mëparshme të vet institucionit, mirëmbajtja vjetore e shërbimeve apo përmirësimit të shërbimeve është rreth 20 %.

3. ■■■■, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të standardeve TIK dhe implementimit të projekteve, me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së me objekt: “Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE”. Ky grup pune, ka kërkuar oferta katër operatorëve ekonomikë, me qëllim përlllogaritjen e fondit limit, në të cilat citohet që bashkëlidhur këtyre shkresave janë vendosur specifikimet teknike. Por edhe pse këto shkresa dhe specifikimet teknike, janë shoqëruar me një preventiv memec për marrjen e ofertave, nga operatorët ekonomikë janë paraqitur oferta saktësisht sipas të njëjtës strukturë, e cila është e njëjtë edhe me strukturën e preventivit të hedhur më vonë në sistemin elektronik të APP-së. Kjo tregon që ofertat janë bërë nga e njëjta dorë dhe përlllogaritja e fondit limit është fiktive dhe e paanalizuar nga grupi i punës.

D.3. Mbështetur në nenin 37 të “Kodit të Punës” i rekomandoj e Drejtorit të Përgjithshëm të AKSHI-t, të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore “Vërejtje me shkrim” deri “Vërejtje me paralajmërim”, në zbatim të nenit 14 të Kontratës individuale të punës për 5 (pesë) persona, si më poshtë:

1. ■■■■, me detyrë specialist në Sektorin e Administrimit të Rrjetit GovNet, me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit Elektrik, Sistemit të Zjarrit, Sistemit CCTV, Sistemit të Access Control, sistemit BMS”, “Sistemit të kondicionimit” dhe “Shërbimi i pastrimit të Qendrës të të Dhënave Qeveritare”. Ky grup pune, ka vendosur që të bëjë përlllogaritjen e fondit limit me mënyrën e testimit të tregut Konstatohet se nuk është vendosur asnjë preventiv nga ku OE të ftuar për ofertë, të bazohen për të dhënë ofertën e tyre. Nga ana tjetër, këta operatorë ekonomikë kanë paraqitur oferta, përpikmërisht sipas të njëjtës strukturë, të gjitha me çmimet në euro dhe me deklarata përpikmërisht të njëjta të operatorëve ekonomikë, gjë që tregon se këto oferta janë fiktive dhe nga grupi i punës duhet të konsideroheshin si të bëra nga e njëjta dorë, duke u refuzuar. Nuk disponohet asnjë dokument ku të jetë bërë një analizë për shërbimet e ofruara nga këta OE në kundërshtim me VKM nr. 1 datë 10.07.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. ■■■■, me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së me objekt “Mirëmbajtja e Sistemit Elektrik, Sistemit të Zjarrit, Sistemit CCTV, Sistemit të Access Control, sistemit BMS”, “Sistemit të kondicionimit” dhe “Shërbimi i pastrimit të Qendrës të të Dhënave Qeveritare”. Ky grup pune, ka vendosur që të bëjë përlllogaritjen e fondit limit me mënyrën e testimit të tregut Konstatohet se nuk është vendosur asnjë preventiv nga ku OE të ftuar për ofertë, të bazohen për të dhënë ofertën e tyre. Nga ana tjetër, këta operatorë ekonomikë kanë paraqitur oferta, përpikmërisht sipas të njëjtës strukturë, të gjitha me çmimet në euro dhe me deklarata përpikmërisht të njëjta të operatorëve ekonomikë, gjë që tregon se këto oferta janë fiktive dhe nga grupi i punës duhet të konsideroheshin si të bëra nga e njëjta dorë, duke u refuzuar. Nuk disponohet asnjë dokument ku të jetë bërë një analizë për shërbimet e ofruara nga këta OE në

kundërshtim me VKM nr. 1 datë 10.07.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

3. ■■■., me detyrë drejtore e Drejtorisë së Vazhdimësisë së Punës BCC, Back-up dhe DRC, me cilësinë e anëtarëve të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së me objekt “Përmirësimi i portalit qeveritar e-albania”. Ky grup pune, ka kërkuar gjashtë oferta operatorëve ekonomikë, me qëllim përllogaritjen e fondit limit. Bashkëlidhur këtyre shkresave janë vendosur specifikimet teknike. Në specifikimet teknike në pikën 8 “Sasia e nevojshme për prokurim”, faqe 28-29, gjenden 11 zëra, përfshirë edhe mirëmbajtjen (SLA) për 4 vjet. Nga auditimi i dokumentacionit për përllogaritjen e fondit limit të administruar në dosje, rezulton se të tre OE kanë dhënë ofertë për 10 zëra (përfshi mirëmbajtjen) dhe e kanë dhënë ofertën sipas të njëjtës strukturë (dmth, të tre me ofertat me 10 zëra). Ky veprim tregon se përllogaritja e fondit limit është bërë në mënyrë fiktive dhe fondi limit i dalë nga ky akt, nuk është real.

Me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, për realizimin e procedurës së me objekt “Blerje software për përpunimin e të dhënave, Arshiva e digjitalizuar dhe pajisje skanimi, server + pajisje depoz të dhëna Arsh dig”. Me Urdhrin nr.395 prot, datë 06.03.2015 të titullarit të Autoritetit Kontraktor (AK) është ngritur grupi i punës për hartimin e termave të referencës. Ky grup pune (përfaqësuesit e AKSHI-t), nuk është caktuar të kryejë përllogaritjen e fondit limit. Konstatohet se gjatë përllogaritjes së bërë nga grupi i punës, mesatarja aritmetike e vlerave të ofertuara është përpikmërisht e njëjtë me të gjitha vlerat e ofertuara nga OE “A.T.S.” shpk. Kjo tregon që përllogaritja e fondit limit është fiktive, e bërë në të njëjtën zyrë dhe e paanalizuar nga grupi i punës.

4. ■■■. me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Menaxhimit të Sistemeve, me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike, për realizimin e procedurës së me objekt “Blerje software për përpunimin e të dhënave, Arshiva e digjitalizuar dhe pajisje skanimi, server + pajisje depoz të dhëna Arsh dig”. Me Urdhrin nr.395 prot, datë 06.03.2015 të titullarit të Autoritetit Kontraktor (AK) është ngritur grupi i punës për hartimin e termave të referencës. Ky grup pune (përfaqësuesit e AKSHI-t), nuk është caktuar të kryejë përllogaritjen e fondit limit. Konstatohet se gjatë përllogaritjes së bërë nga grupi i punës, mesatarja aritmetike e vlerave të ofertuara është përpikmërisht e njëjtë me të gjitha vlerat e ofertuara nga OE “A.T.S.” shpk. Kjo tregon që përllogaritja e fondit limit është fiktive, e bërë në të njëjtën zyrë dhe e paanalizuar nga grupi i punës.

5. ■■■. me detyrë specialist në Sektorin e Infrastrukturës Mbështetëse të Sistemeve, me cilësinë e anëtarit të grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përllogaritjen e fondit limit për realizimin e procedurës së prokurimit me objekt “Mirëmbajtja e sistemeve Oracle Audit Vault (përfshirë mirëmbajtjen për periudhën 2 vjeçare)”.

Nga auditimi rezulton se në termat e referencës kërkohet të mirëmbahet “Oracle Audit Vault për bazën e të dhënave të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave”, “Oracle Audit Vault për bazën e të dhënave për sistemin CMIS të administruar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore” dhe “Oracle Audit Vault për bazën e të dhënave të Agjencisë së Prokurimit Publik”. Nga realizimi i prokurimeve të vitit 2014, konstatohet gjithashtu se ofertat ekonomike të OE fitues në objektet e mësipërme (tashmë të parashikuara për mirëmbajtje) janë respektivisht 4,140,000 lekë pa tvsh (T.S.), 6,339,000 lekë pa tvsh (It) dhe 6,425,000 lekë pa tvsh (F.), ose të tre objektet 16,904,000

lekë gjithsej. Sa sipër rezulton që mirëmbajtja vjetore të jetë 32% (5,400,000 lekë/16,904,000 lekë vlera e implementimit). Në autoritetin kontraktor është realizuar një procedurë prokurimi me objekt “Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE”, e zhvilluar në Qershor 2014 në të cilin ekziston një zë i ngjashëm, i cili mund të merrej në konsideratë në përlllogaritjen e fondit limit, bazuar në nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Nëse do të veprohej sipas këtij VKM dhe të bëhej një përlllogaritje duke iu referuar alternativës b), do të konsiderohej si vlerë e mirëmbajtjes vjetore 22% e vlerës së implementimit, sipas përlllogaritjes së fondit limit nga AK, ose 15 % e implementimit sipas ofertës së dhënë nga OE fitues i asaj procedure (që është njëkohësisht edhe fitues i kësaj procedure). Nëse do të merrnim për bazë përqindjen e mirëmbajtjes në lidhje me implementimin, përdorur nga vetë AK, pra 22%, atëherë fondi limit i kësaj procedure prokurimi do të ishte 7,437,760 lekë pa tvsh (16,904,000 implementimi gjithsej, i kryer më parë x 22% mirëmbajtja vjetore x 2 vjet), ose 3,362,240 lekë më pak se fondi limit i prokuruar.

D/3. Për punonjësit e larguar nga detyra dhe që nuk kanë adresim institucional:

Për ish punonjës, nuk mund të rekomandohet masë disiplinore, edhe pse shkeljet e natyrës administrative të konstatuara, pavarësisht se ekzistojnë, nuk mund të ezaurohen si të tilla, pasi personat e sipërpërmendur nuk janë në marrëdhënie pune me këtë institucion dhe nuk ka adresim institucional për dhënien e zbatimin e tyre. Për sa sipër të merren masa dhe të njoftohet Departamenti i Administratës Publike, për masën disiplinore mbi bazën e shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit për 11 ish-punonjës, si më poshtë:

1. E.Sh.
2. M.P.
3. P.GJ.
4. I.B.
5. R.Q.
6. J.O.
7. J.P.
8. A.M.
9. E.M.

Për shkeljet: Me cilësinë e anëtarëve të grupeve të punës për përlllogaritjen e fondit limit, pasi përlllogaritja e fondit limit është bërë në kundërshtim me nenin 59 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, mungon analiza e zërave të preventivit të investimit, duke bërë që të miratohet fondi limit i prokurimit jo real.

10. A.B.
11. J.R.

Për shkeljet: Me cilësinë e nëpunësve zbatues (NA) dhe përgjegjës të Sektorit të Financës, Buxhetit dhe Shërbimeve, për shkeljet e konstatuara gjatë auditimit mbi planifikimin e buxhetit dhe ligjshmërinë e kontabilizimit të veprimeve të hyrjeve dhe daljeve të magazinës, *trajtuar në faqe 23-42 dhe 50-64 të Raportit Përfundimtar.*

E. MASA ADMINISTRATIVE:

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike të nenit 12, 20, 23, 24, 28 dhe 46 të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe neneve 9, 17, 22, 28, 40, 56, 57, 58, 59, 65, 66 dhe 75, të VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe përgjegjësi individuale të evidentuar dhe pasqyruar në procesverbalet e mbajtura gjatë auditimit, vërejtjeve, komenteve të subjektit të audituar dhe pjesës së Raportit Përfundimtar të Auditimit;

Mbështetur në nenet 13 dhe 72, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në germën (c dhe ç) të nenin 15 dhe nenin 30, të ligjit nr. 154/2014, datën 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandoj Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për punonjësit, si më poshtë:

Nr	Emër mbiemër	Objekti i Prokurimit
1	M.K.	Për të gjitha procedurat e prokurimit të konstatuara me shkelje dhe mangësi, në cilësinë e titullarit të Autoritetit Kontraktor.
2	E.Z.	“Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE” “Shtimi i shërbimeve të reja elektronike në Portalin Qeveritar e-Albania”
3	V.P.	“Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE” “Sistemi multifunksional i qendëruar i lejeve të ndërtimit” “Blerje software për përpunimin e të dhënave, Arshiva e digjitalizuar dhe pajisje skanimi, server + pajisje depoz të dhëna Arsh dig” “Shtimi i shërbimeve të reja elektronike në Portalin Qeveritar e-Albania”
4	Y.Ç	“Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE” “Shtimi i shërbimeve të reja elektronike në Portalin Qeveritar e-Albania” “Platforma qeveritare e ndërvëprimit. Riinxhinierim e modernizim të 51 proceseve të punës G2G, zgjerim me 21 shërbime të reja elektronike G2G, G2C dhe G2B dhe shtimi i 6 shërbimeve të reja në portalin qeveritar e-albania.al” “Shtimi i 209 shërbimeve elektronike për 18 institucione” “Shtimi i shërbimeve të reja elektronike në Portalin Qeveritar e-Albania” “Lidhja me fibër optike e Komisariateve të Policisë dhe drejtorive nëpërmjet rrjetit qeveritar Govnet”
5	B.P.	“Platforma qeveritare e ndërvëprimit. Riinxhinierim e modernizim të 51 proceseve të punës G2G, zgjerim me 21 shërbime të reja elektronike G2G, G2C dhe G2B dhe shtimi i 6 shërbimeve të reja në portalin qeveritar e-albania.al” “Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE” “Lidhja e sistemit në Platformën Qeveritare të Ndërvëprimit dhe Shtimi i Shërbimeve të reja në portalin qeveritar e- Albania” “Përmirësimi i portalit qeveritar e-albania”
6	L.B.	“Platforma qeveritare e ndërvëprimit. Riinxhinierim e modernizim të 51 proceseve të punës G2G, zgjerim me 21 shërbime të reja elektronike G2G,

		G2C dhe G2B dhe shtimi i 6 shërbimeve të reja në portalin qeveritar e-albania.al” “Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE” “Përmirësimi i portalit qeveritar e-albania” “Shtimi i shërbimeve të reja elektronike në Portalin Qeveritar e-Albania” “Shtimi i 209 shërbimeve elektronike për 18 institucione”
7	S.Gj.	“Blerje sistemi për vazhdueshmërinë e punës, rikuperimin nga fatkeqësia dhe back-up për të gjitha sistemet qeveritare të bazuara në zgjidhje ORACLE DATABASE”
8	I.D.	“Mirëmbajtja e Sistemit Elektrik, Sistemit të Zjarrit, Sistemit CCTV, Sistemit të Access Control, sistemit BMS”, “Sistemit të kondicionimit” dhe “Shërbimi i pastrimit të Qendrës të të Dhënave Qeveritare” “Lidhja me fibër optike e Komisariateve të Policisë dhe drejtorive nëpërmjet rrjetit qeveritar Govnet”
9	B.Xh.	“Mirëmbajtja e Sistemit Elektrik, Sistemit të Zjarrit, Sistemit CCTV, Sistemit të Access Control, sistemit BMS”, “Sistemit të kondicionimit” dhe “Shërbimi i pastrimit të Qendrës të të Dhënave Qeveritare”
10	B.V,	“Përmirësimi i portalit qeveritar e-albania” “Blerje software për përpunimin e të dhënave, Arshiva e digjitalizuar dhe pajisje skanimi, server + pajisje depoz të dhëna Arsh dig” “Shtimi i 209 shërbimeve elektronike për 18 institucione” “Shtimi i shërbimeve të reja elektronike në Portalin Qeveritar e-Albania”
11	M.S.	“Blerje software për përpunimin e të dhënave, Arshiva e digjitalizuar dhe pajisje skanimi, server + pajisje depoz të dhëna Arsh dig”
12	L.K.	“Mirëmbajtja e sistemeve Oracle Audit Vault (përfshirë mirëmbajtjen për periudhën 2 vjeçare)”

G. PËR AUTORITETIN E KONKURRENCËS

Nga auditimi i ushtruar në procedurat e prokurimit publik për vitin 2014-2015 në Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit, konstatohet se:

- Në procedurën e prokurimit “Shtimi i 209 shërbimeve elektronike për 18 institucione”, ofertat e paraqitura për përlogaritjen e fondit limit janë marrë nga tre operatorë ekonomikë, të cilët në fund të procedurës së prokurimit rezultojnë të jenë pjesë e Bashkimit të Operatorëve Ekonomikë të shpallur fitues nga Autoriteti Kontraktor, element ky i ekzistencës së një marrëveshjeje të ndaluar.

Kjo mënyrë konkurrimi sjell si pasojë, që një grup i vogël operatorësh ekonomikë të kontrollojnë një pjesë të gjerë të tregut të shërbimit të informacionit, duke hyrë në marrëveshje të fshehtë mes tyre dhe monopolizuar tregun.

Për sa më sipër është rekomanduar:

Të njoftohet Autoriteti i Konkurrencës, në referim të Ligjit nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” neni 4, si dhe në bazë të detyrimit që rrjedh nga marrëveshja e bashkëpunimit me KLSH-në, të hetojë për rrezikun e ekzistencës së një marrëveshjeje të ndaluar në oferta për prokurimet publike zhvilluar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit për vitin 2014-2015.

H. TË TJERA

1. Duke vlerësuar rëndësinë që ka ngritja e sistemeve informative të qëndrueshme, të sigurta dhe promovimi i sistemeve e-goverment të mirë strukturuar dhe funksionale sipas qëllimit për të cilën projektohen, materiali i këtij auditimi t'i përcillet **Ministrit për Inovacionin dhe Teknologjinë e Informacionit e të Komunikimit**, për të rritur sensibilitetin për ndërhyrjet e domosdoshme që kërkon cilësia dhe siguria e këtyre investimeve të reja që po shpenzojnë fonde të konsiderueshme buxhetore.

2. Në zbatim të programit të auditimit nr. 1134/1, datë 11.12.2015, ndryshuar me shkresën nr.1134/5, datë 15.02.2016, u krye auditimi “Mbi klasifikimin origjinal të informacionit sekret shtetëror”, për të cilin në zbatim të nenit 28 të Ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “*Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit*”, është përgatitur një raport i veçantë auditimi nga auditues i certifikuar, i mbikëqyrur nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm dhe nga Drejtori i Departamentit Juridik, Sigurimit të Cilësisë dhe Zbatimit të Standardeve, të certifikuar nga Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar. Raporti Përfundimtar i këtij auditimi, i konsideruar “konfidencial” dhe i miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr.74, datë 30.06.2016, i përcillet subjektit në përputhje me rregullat e mbajtjes së dokumentacionit “sekret shtetëror”.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm dhe Departamenti Juridik, Kontrollit të Zbatimit të Standardeve dhe Etikës.